

Partnerë të projektit:



Projekti u zhvillua në kuadër të CIVILISC

Zbatuar nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim



Financuar nga BE



Raport Vlerësues

“Pjesëmarrja e publikut në procesin e vendimmarrjes vendore”

Nëntor, 2017

Botues: Lex Ferenda
Datë: Nëntor 2017
Autor: Lex Ferenda

Përgatiti dhe hartoi: Aljula Gjeloşi

Me kontributin e : Anjeza Gashi, Olsi Çoku, Margarita Buxhaku, Agim Blloshmi,
Vilson Shehu, Lindita Luzo

Agjentët në terren: Elton Qendro, Edjola Terziu, Artiola Bejdo, Anastasia Niko

Kontakt: info@lexferenda.al

Dizajn dhe faqosje: GLA studio

Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e Qendrës “Lex Ferenda” dhe organizatave “The Youth of Ura”, “Albanian Centre for Environmental Governance”, “Syri i Medias së Lirë” dhe Shoqatës “Egnatia”, si partnerë zbatues të projektit “Pjesëmarrja e Publikut në Procesin e Vendimmarrjes Vendore” dhe në asnjë rast nuk reflekton pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

Mirënjohje

Ky punim është mundësuar nga Qendra Lex Ferenda dhe ekipi i saj dëshiron të falenderojë për bashkëpunimin: Bashkitë Devoll, Prrenjas, Libohovë, Ura Vajgurore, nëpunësit e administratës së këtyre bashkive, si dhe qytetarët pjesëmarrës në kërkim. Gjithashtu, realizimi i kërkimit nuk do të ishte i mundur pa kontributin e vyer të partnerëve të terrenit: Albanian Centre for Environmental Governance (ACEG) për Devollin, The Youth of Ura (YUV) për Urën Vajgurore, Fundacioni Syri i Medias së Re (SMR) për Libohovën dhe Shoqatës Egnatia për Librazhdin.

Tabela e përmbajtjes

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	5
Qëllimi	6
Gjetjet kryesore.....	6
1. HYRJE	7
1.1 Transparenca e aktiviteteve të bashkisë dhe pjesëmarrja e publikut në vendimmarrjen vendore	8
2. METODOLOGJIA	9
2.1. Hartimi i studimit	10
2.2. Kampionimi	10
2.3. Instrumentet kërkimore	11
2.4. Mbledhja dhe analiza e të dhënave.....	11
2.5. Konsiderata etike	11
2.6. Karakteristikat e pjesëmarrësve	11
3. TË DHËNAT PËR BASHKINË DEVOLL	12
3.1. Profili i Bashkisë.....	13
3.2 Të dhënat e pyetësorëve për Bashkinë Devoll	14
3.3 Monitorimi i aktiviteteve të Bashkisë	28
4. TË DHËNAT PËR BASHKINË PRRENJAS	29
4.1. Profili i Bashkisë.....	30
4.2 Të dhënat e pyetësorëve për Bashkinë Prrenjas.....	30
4.3 Monitorimi i aktiviteteve të Bashkisë Prrenjas.....	44
4. TË DHËNAT PËR BASHKINË LIBOHOVË	45
5.1 Profili i Bashkisë	46
5.2 Të dhënat e pyetësorëve për Bashkinë Libohovë.....	47
5.3 Monitorimi i aktiviteteve të Bashkisë Libohovë.....	59
6. TË DHËNAT PËR BASHKINË URA VAJGURORE	60
6.1 Profili i Bashkisë	61
6.2 Të dhënat e pyetësorëve për bashkinë Ura Vajgurore	62
6.3 Monitorimi i aktiviteteve të Bashkisë	73
KONKLUZIONE	75
SHTOJCA 1	78
SHTOJCA 2	83

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky studim është përgatitur në kuadër të projektit “Pjesëmarrja e publikut në procesin e vendim-marrjes vendore”, i cili mbështetet nga fondi i nën-grantimit “Anti-korrupsioni dhe zhvillimi i kapaciteteve”, në kuadër të projektit CIVILISC, financuar nga BE, Zbatuar nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM).

Qëllimi i këtij projekti është të kontribuojë në rritjen e cilësisë, gjithëpërfshirjes dhe transparencës së procesit të vendimmarrjes në katër bashkitë e vogla, përkatësisht: Devoll, Prrenjas, Libohovë, Ura Vajgurore.

Qëllimi i këtij raporti është jo vetëm pasqyrimi i monitorimit të punës së bashkive dhe perceptimeve të qytetarëve lidhur me procesin e vendimmarrjes, por do të shërbejë si bazë për hartimin e udhëzuesve/manualëve në ndihmë të bashkive lidhur me hartimin e politikave vendore.

Ndarja aktuale administrative dhe territoriale e njësive të qeverisjes vendore në Shqipëri në 61 njësi është miratuar në Korrik të vitit 2014 nga Kuvendi Shqiptar.

Reforma administrative–territoriale u planifikua dhe po zbatohet në bazë të tre objektivave strategjikë: i) përmirësimi i shërbimeve për qytetarët në nivel vendor, ii) rritja e efikasitetit dhe mirëqeverisjes në nivel vendor, iii) fuqizimi i qeverisjes vendore, qytetarëve dhe komuniteteve¹.

Reforma administrativo-territoriale synon përmirësimin e cilësisë së shërbimeve publike vendore nëpërmjet rritjes së efikasitetit të tyre, por edhe të aksesit të qytetarëve në shërbimet publike vendore.

Synim është gjithashtu reformimi dhe forcimi i qeverisjes vendore dhe administratës publike në përgjithësi, rritja e efikasitetit dhe transparencës së institucioneve publike për t’iu përgjigjur me efektivitet pritshmërive të publikut dhe luftës kundër korrupsionit, vënia e qytetarëve në qendër të transformimit dhe modernizimit të ofrimit të shërbimeve dhe krijimi i një frymë besimi, bashkëpunimi dhe vendimmarrje demokratike për zhvillim të shëndetshëm e të qëndrueshëm.

Në këtë kuadër, perceptimet e qytetarëve për ofrimin e shërbimeve publike dhe transparencën e tyre janë një instrument i domosdoshëm për ngritjen dhe përmirësimin e tyre. Përdorimi i këtyre perceptimeve është bërë shumë i shpeshtë në kërkimet në fushën e administrimit publik.

¹ Miratuar me ligjin nr. 115/2014, datë 31.7.2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”

Qëllimi

Qëllimi i këtij raporti është të vlerësojë transparencën dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen vendore në Bashkitë Devoll, Libohovë, Prrenjas, Ura Vajgurore, si dhe të nxjerrë në pah pritshmëritë e pjesëmarrësve për përmirësimin e këtyre shërbimeve.

Specifikisht objektivat e kërkimit janë:

- Të vlerësohet transparenca dhe përfshirja e publikut në vendimmarrjen vendore në Bashkitë Devoll, Libohovë, Prrenjas, Ura Vajgurore;
- Nisur nga perceptimet e qytetarëve të këtyre bashkive, të analizohen komponentët pozitivë dhe negativë të shërbimeve të ofruara;
- Të evidentohen pritshmëritë e pjesëmarrësve për shërbimet e ofruara.

Target grupi parësor janë banorët e bashkive në fjalë dhe organizatat e shoqërisë civile, të cilët janë edhe përfituesit, ashtu si dhe vetë bashkitë.

Ky kërkim është bazuar në një metodologji mikse, sasiore dhe cilësore. Instrumenti kryesor i përdorur për vlerësimin e shërbimeve është pyetësori, me një metodologji sasiore. Numri i pjesëmarrësve që iu përgjigjën pyetësorëve është N = 400. Kampionimi është rastësor dhe gjatë intervistimit është mbajtur parasysh një balancë në përfshirjen e të intervistuarve sipas moshës, gjinisë dhe profesioneve. Mbulimi gjeografik i studimit është për Bashkitë Devoll, Libohovë, Prrenjas, Ura Vajgurore dhe duke marrë parasysh se është përdorur një kampionim probabilitar, të dhënat tregojnë prirjet e pjesëmarrësve të këtij studimi.

Për të eksploruar më tej mbi gjetjet e sondazhit, me fokus transparencën e aktiviteteve të bashkisë dhe pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrjen vendore, janë realizuar monitorime të instrumenteve dhe aktiviteteve të bashkive përkatëse nga partnerët lokalë, në një periudhë kohore pesë mujore (Maj – Shtator 2017), për të mundësuar kështu edhe elementin cilësor të këtij raporti.

Gjetjet kryesore

- Pjesa më e madhe e pjesëmarrësve nuk janë, apo janë pjesërisht të informuar mbi veprimtarinë e bashkive në shqyrtim.
- Ekzistojnë mangësira në transparencën e strukturave dhe instrumenteve të bashkive që do të mundësonin informimin në kohë të qytetarëve mbi strukturat dhe aktivitetet e bashkive.
- Qytetarët kërkojnë të marrin pjesë më shumë në vendimmarrje, të informohen më shumë dhe të kenë më shumë “zë” për çështjet që i interesojnë, në mënyrë që të bëhen pjesë aktive në hartimin e politikave dhe në vendimmarrje.

1. HYRJJE



1.1 Transparenca e aktiviteteve të bashkisë dhe pjesëmarrja e publikut në vendimmarrjen vendore

Parimit të transparencës i është kushtuar një interes në rritje në legjislacion, veçanërisht i theksuar në vitet e fundit, në përputhje me evolucionin e modelit të administratës publike drejt qeverisjes së hapur. Parimi i transparencës është në fakt çelësi për të siguruar hapjen e asetëve të informacionit publik, i cili u lejon qytetarëve të monitorojnë vazhdimisht aktivitetin, duke promovuar në të njëjtën kohë përgjegjësinë e administratorëve publikë.


Transparenca, si një mjet për të siguruar performancë të mirë dhe paanshmërinë e institucioneve, duhet të karakterizojë administratën publike dhe tashmë përcakton parimin e veprimtarisë administrative, përveç kritereve ekonomike, efektivitetit, paanshmërisë dhe reklamimit.

Dukshmëria e veprimit administrativ, e garantuar nga transparenca, gjithashtu nuk synon të sigurojë një vëzhgim të thjeshtë të aktiviteteve të administratave publike dhe të dhënave të saj, por bëhet një instrument i vërtetë i demokracisë pjesëmarrëse, në bazë të së cilës qytetari fiton vetëdije dhe merr pjesë në elaborimin e politikave publike.

Parimi i transparencës gjen një aleat të fortë në web, i cili vendos informacionin në dispozicion të një numri të pacaktuar subjektsh, të cilët në çdo kohë mund të përfitojnë nga ky shërbim nga vende të ndryshme fizike.

Duke u mbështetur në rëndësinë e këtij parimi, me anë të këtij raporti është hedhur dritë mbi situatën aktuale në bashkitë objekt të studimit dhe janë analizuar gjetjet e sondazheve të kryera.

2. METODOLOGJIA



2.1. Hartimi i studimit

Ky kërkim është bazuar në një metodologji mikse, sasiore dhe cilësore. Instrumenti kryesor i përdorur për vlerësimin e shërbimeve është pyetësori, me një metodologji sasiore. Numri i pjesëmarrësve që iu përgjigjën pyetësorëve është $N = 400$. Kampionimi është rastësor, dhe gjatë intervistimit është mbajtur parasysh një balancë në përfshirjen e të intervistuarve sipas moshës, gjinisë dhe profesioneve. Mbulimi gjeografik i studimit është për bashkitë Devoll, Libohovë, Prrenjas, Ura Vajgurore dhe, duke marrë parasysh se është përdorur një kampionim probabilitar, të dhënat tregojnë prirjet e pjesëmarrësve të këtij studimi e mund të përgjithësohen në të gjithë popullatën e bashkive në fjalë.

Për të eksploruar më tej mbi gjetjet e sondazhit, me fokus transparencën e aktiviteteve të bashkisë dhe pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrjen vendore, janë realizuar monitorime të aktiviteteve të bashkive përkatëse nga partnerët lokalë, në një periudhë kohore pesë mujore, për të mundësuar kështu edhe elementin cilësor të këtij raporti.

2.2. Kampionimi

Për pjesën sasiore, kuadri i kampionit përfshinte individët mbi moshën 17 vjeç, të cilët nuk ishin vetë punonjës në bashkitë Devoll, Libohovë, Prrenjas, Ura Vajgurore ose nuk kishin të afërm në familjen bazë të punësuar aty. Kampioni përfundimtar përbëhej nga $N = 400$ pjesëmarrës. Një kampion i tillë ofron një nivel më të lartë saktësie në sondazh. Kampioni i përzgjedhur ishte ai i shtresëzuar duke marrë parasysh mungesën e një kuadri të saktë të kampionimi.

Intervistuesit kanë përdorur një kampionim rastësor për të realizuar sondazhin; ata/o janë udhëzuar që të jenë të vëmendshëm në mënyrë që të përfshijnë sa më shumë që të jetë e mundur pjesëmarrës të grupeve të ndryshme moshore. Në mënyrë që të përfshiheshin më shumë qytetarë që kanë patur kontakte me shërbime, intervistuesit u udhëzuan që të qëndrojnë afër zyrave të bashkisë. Kriteret e përjashtimit nga sondazhi ishin: (i) mosha nën 17 vjeç dhe (ii) të pasurit e një anëtari të familjes bazë nënpunës në Bashkitë Devoll, Libohovë, Prrenjas, Ura Vajgurore.

Në mënyrë të përmbledhur kampioni i studimit shihet në tabelën e mëposhtme (Tabela 1).

Tabela 1: Të dhëna mbi kampionin e studimit

Bashkia/Zona	Nr total i të anketuarve	Femra/ Meshkuj		Arsimi			Profesioni
				I ulët	I mesëm	I lartë	
Devoll	100	48	52	25	40	35	Studentë, ekonomistë, juristë, infermierë, minororë, edukatorë, të papunë, pensionistë, bujq, edukatore etj.
Prrenjas	100	36	64	23	42	30	
Libohovë	100	49	51	25	47	28	
Ura Vajgurore	100	52	48	19	59	21	

2.3. Instrumentet kërkimore

Instrumentet kërkimore të përdorur për këtë studim janë zhvilluar nga kërkuesit duke u bazuar në literaturën bashkëkohore vendase dhe ndërkombëtare. Një pyetësor me pyetje të mbyllura është përdorur për pjesën sasiore, i cili ishte ndarë në 7 seksione të ndryshme: Informimi, Këshilli Bashkiak, Mbledhjet e Këshillit Bashkiak, Seancat e Këshillimeve me Bashkësinë, pjesëmarrja në organizimet komunitare (Këshilli Komunitar), Diskutime në Publik dhe seksioni i informacionit mbi të intervistuarin. (Shih Shtojcën 1: Pyetësi i studimit “Transparenca dhe përfshirja e publikut në vendim-marrjen vendore”).

Për pjesën cilësore është zhvilluar si instrument: “Modeli për monitorim të aktiviteteve të Bashkive Devoll, Prrenjas, Libohovë dhe Ura Vajgurore” (shih Shtojcën 2).

2.4. Mbledhja dhe analiza e të dhënave

Intervistuesit e terrenit u trajnuan për administrimin e pyetësorit. Administrimi i pyetësorit ka zgjatur rreth tre muaj, Maj – Korrik të vitit 2017.

Administrimi i monitorimit ka zgjatur rreth pesë muaj, Maj – Shtator të vitit 2017.

Të dhënat sasiore u analizuan duke përdorur programin statistikor SurveyMonkey.com.

Për analizën e të dhënave cilësore është përdorur përmbledhja e analizës së të dhënave të përfutuara nga monitorimet.


2.5. Konsiderata etike

Të gjithë pjesëmarrësit e këtij studimi kanë dhënë pëlqimin e tyre për pjesëmarrjen në studim. Pjesëmarrja ishte vullnetare. Të gjitha të dhënat janë trajtuar në mënyrë konfidenciale dhe janë përdorur vetëm për efekte studimi.

2.6. Karakteristikat e pjesëmarrësve

Një numër total prej N = 400 pjesëmarrësish është bërë pjesë e studimit. 46% ishin femra dhe 54% meshkuj. Përsa i takon moshës: rreth 5% e të intervistuarve i takon moshës nën 18 vjeç, 26% e të intervistuarve i përket moshës 18-30 vjeç, 36% moshës 30-50 vjeç dhe 32% i takon moshës mbi 50 vjeç.

Tabela 2: Të dhëna mbi moshën e të intervistuarve



3. TË DHËNAT PËR BASHKINË DEVOLL



3.1. Profili i Bashkisë

Devolli kufizohet në veri me Bashkinë Pustec, në perëndim me bashkitë Maliq dhe Korçë, në jug me bashkinë Kolonjë, ndërsa në lindje me Greqinë.

Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Bilishtit. Devolli ka 4 komuna dhe 47 fshatra. Sipas Censurit të vitit 2011, bashkia e re numëron 26.716 banorë, ndërsa sipas Regjistrisë Civil kjo bashki numëron një popullsi prej 42.388 vetësh. Bashkia e re ka një sipërfaqe prej 453.27 km².

Kjo bashki përbëhet nga 5 njësi administrative, të cilat janë: Bilisht, Qendër Bilisht, Hoçisht, Progër dhe Miras. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e rrethit të Devollit dhe qarkut të Korçës. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 44 fshatra.

Bashkia e Devollit është një zonë që dominohet nga popullsia fshatare, sigurimi i të ardhurave të cilës mbështeten në dy burime kryesore, bujqësia dhe blegtoria nga njëra anë dhe remitancat nga emigracioni nga ana tjetër. Për shkak të pozicionit të saj kufitar me shtetin grek, një numër i konsiderueshëm banorësh kanë emigruar prej vitesh, duke gjeneruar të ardhura jo vetëm për veten e tyre por edhe për familjet e fshatrave. Shumë zona të Devollit kanë pësuar zhvendosje masive të popullsisë ku banorët kanë braktisur totalisht fshatrat e thellë për t’u vendosur në zona më afër qytetit duke u fokusuar tek puna në bujqësi për shkak se toka është produktive. Përveç kultivimit të kulturave të ndryshme, si të lashtat dhe perimet, banorët merren shumë me pemëtarinë duke qenë ndër zonat me prodhim më të lartë në vend. Blegtoria është një tjetër aspekt përmes të cilës banorët gjenerojnë të ardhura.

Investimet në infrastrukturë kanë qenë të mjaftueshme, por ka mangësi në rrugët dytësore të cilat do ishin në funksion të fermerëve për të lehtësuar aksesin në tokat bujqësore, si dhe ndërlidhjen e fshatrave të thellë të njësisë administrative Miras.

Banorët kanë gjetur zgjidhjet e tyre individuale duke u fokusuar më së shumti tek bujqësia por sigurimi i kapaciteteve grumbulluese frigoriferike dhe tregjeve të shitjes janë dy nga sfidat me të cilat do të përballen pushteti vendor pas ndarjes së re.

Furnizimi me ujë të pijshëm, klorifikimi i tij, por edhe rrjetet e kanalizimeve identifikohen si fusha të cilat kërkojnë ndërhyrje për shkak të gjendjes alarmante në të cilën ndodhen. Nga ana tjetër, zona ka një popullsi të dendur dhe mungesa e vendgrumbullimeve dhe përpunimit të mbetjeve urbane ka sjellë ndotje në nivele të larta, çka ngre domosdoshmërinë që bashkia e re të ngrejë mekanizma për mbledhjen dhe menaxhimin e tyre në të gjithë zonën.

Një sfidë tjetër me të cilën do të duhet të përballen bashkia e re është me mbrojtja dhe rehabilitimi i pyjeve të zonës, përmes rritjes së ndërgjegjësimit të banorëve për dëmin afatgjatë mjedisor dhe ekonomik, si dhe ndalimi i kapërcimit të kufirit me Greqinë për prerje të jashtëligjshme të pyjeve.

Devolli ka një traditë të pasur vlerash dhe kulturash, por thuhet në të gjithë zonën mungojnë grupet artistike, ndërsa edhe për fëmijët dhe të rinjtë nuk ka ambiente dhe kënde sportive ndaj njësisia vendore duhet të hartojë politika mbështetëse për kulturën dhe arsimin, si dhe sitet historike dhe arkeologjike të zonës, si Shpella e Trenit.

Sfidë për bashkinë mbetet edhe zhvillimi i turizmit ku promovimi i fshatrave me relief

malor dhe pyllësi të dendur, si dhe zonës së Liqenit të Prespës do të ishte një hapësirë shumë e mirë për zhvillimin e turizmit malor dhe ekoturizmit, ndërsa ngritja e një muzeu historik-kulturor dhe forcimi i politikave të bashkëpunimit me homologët e lokaliteteve greke do zgjeronte interesin turistik sidomos nëpërmjet organizimit të panairëve si një model i gatshëm nga pala tjetër.

3.2 Të dhënat e pyetësorëve për Bashkinë Devoll

Nisur nga ky vështrim i shkurtër i profilit të kësaj bashkie mund të vihet re se problematikat të cilat prekin komunitetin nuk janë të pakta, dhe se kërkojnë si domosdoshmëri përfshirjen e qytetarëve në veprimtarinë administrative dhe llogaridhënien e qeverisësve. Le të njohim nga afër si zbatohet parimi i transparencës, si një nga instrumentet që bën të mundur një qeverisje cilësore dhe gjithëpërfshirëse.

Pyetësori i hartuar për këtë qëllim ndahet në seksione me pyetje sipas tematikave në vijim: Informimi; Këshilli Bashkiak; Mbledhjet e Këshillit Bashkiak, Seancat e Këshillimit me Bashkësinë; pjesëmarrja në organizimet komunitare: Këshilli Komunitar; Diskutime në Publik.

Pyetësorit iu përgjigjen femra dhe meshkuj pothuajse në të njëjtën masë dhe rreth 40% e të intervistuarve i përkiste grupmoshës 30-50 vjeç, ndërsa rreth 30% u përkisnin repektivisht grupmoshave 18-30 vjeç dhe mbi 50 vjeç. Profesionet e të intervistuarve ishin nga më të larmishmet, duke pasqyruar kështu edhe nivelin arsimor të tyre. Rreth 75% e të intervistuarve kishin arsim të mesëm e të lartë dhe rreth 25% e tyre arsim të ulët (shih figurat 1, 2, 3).

Gjinia?

Answered: 97 Skipped: 3




Figura 1: Gjinia (Devoll)

Mosha?

Answered: 97 Skipped: 3




Figura 2: Mosha (Devoll)

Arsimi?

Answered: 98 Skipped: 2




Figura 3: Arsimi (Devoll)

Seksioni i parë i pyetësorëve ka të bëjë me informimin. Pyetjes nëse qytetarët kanë paraqitur ndonjëherë kërkesë për informacion u është përgjigjur pozitivisht rreth 52% e popullsisë, që dëshmon nevojën e tyre për informim (shih figurën 4). 48% e qytetarëve nuk kanë bërë asnjëherë një kërkesë të tillë.

Keni paraqitur ndonjëherë kërkesë për informacion në bashki?

Answered: 100 Skipped: 0




Figura 4: Kërkesë për informim në Bashki (Devoll)

Pyetjes lidhur me përgjigjen e shpejtë nga bashkia, apo nëse kanë marrë informacionin e kërkuar u është drejtuar vetëm të intervistuarve që i janë përgjigjigjur pozitivisht pyetjes së mësipërme, lidhur me kërkesën për informacion. Vetëm 60% e të intervistuarve pohon se ka marrë përgjigje në kohë të shpejtë, ndërsa rreth 40% e tyre duke dhënë përgjigje negative, vlerëson negativisht punën e administratës (figura 5).

Ju kanë kthyer përgjigje në një kohë të shpejtë?

Answered: 58 Skipped: 42




Figura 5: Përgjigje e shpejtë nga Bashkia Devoll

Rreth 70% e të intervistuarve pohon të ketë marrë informacionin e kërkuar, ndërsa rreth 30% e tyre përgjigjet negativisht (figura 6). Rezultatet e pyetësorëve tregojnë se në total rreth 70% e të intervistuarve që kanë kërkuar informacion në bashkinë Devoll ose nuk e kanë marrë në kohë të shpejtë ose nuk e kanë marrë fare atë.

A e keni marrë informacionin e kërkuar?

Answered: 59 Skipped: 41




Figura 6: Marrja e informacionit të kërkuar (Devoll).

Rreth 74% e të anketuarve nuk e dinë se në bashkinë e tyre ka një program transparence dhe një koordinator për transparencën (figura 7). Gati në të njëjtën masë, nuk kanë informacion se në bashki ka një koordinator për njoftimin dhe konsultimin publik (figura 8). Pra pjesa më e madhe e të intervistuarve në bashkinë Devoll nuk janë fare në dijeni të ekzistencës së strukturave dhe instrumenteve që sigurojnë transparencën, por edhe përfshirjen publike në vendimmarrje (rreth 75%).

A e dini se në bashki ka një koordinator për transparencën e institucionit dhe një program transparence?

Answered: 96 Skipped: 5




Figura 7: Informimi i qytetarëve mbi programin dhe koordinatorit për transparencën (Devoll)

A e dini se në bashki ka një koordinator për njoftimin dhe konsultimin publik?

Answered: 94 Skipped: 6




Figura 8: Informimi i qytetarëve mbi praninë e koordinatorit për njoftim dhe konsultim publik (Devoll)

Nga të anketuarit, vetëm rreth 65% e dinë se bashkia ka një faqe interneti dhe vetëm 50% e atyre që janë në dijeni të ekzistencës së kësaj faqeje, merr informacion nga kjo e fundit (figurat 9 dhe 10). Nga një analizë e kryqëzuar e këtyre të dhënave vihet re se vetëm rreth 32% e të intervistuarve arrin të marrë informacion nga faqja e internetit të bashkisë Devoll. Pjesa më e madhe e të intervistuarve nuk përfiton apo nuk është e kënaqur nga ky instrument.

A e dini nëse bashkia juaj ka faqe interneti?

Answered: 96 Skipped: 4




Figura 9: Informimi mbi faqen e internetit të Bashkisë (Devoll)

A merrni ndonjëherë informacion nga kjo faqe?

Answered: 78 Skipped: 22




Figura 10.: Informacioni i marrë nga faqja e internetit (Devoll)

Pyetjes lidhur me perceptimet e të intervistuarve mbi punën e sportelit të informacionit në bashkinë Devoll i përgjigjet duke e vlerësuar pozitivisht rreth 65% e të anketuarve. Pjesa tjetër ose shprehen të pakënaqur pasi mendojnë se nuk jep ofron shërbimin e kërkuar (6%), nuk jep informacionin e kërkuar në kohën e duhur (8%) apo për arsye të tjera nuk është e kënaqur nga puna e sportelit të informacionit (20%) (shih figurën 11).




Tabela 11.: Vlerësimi për punën e sportelit të Bashkisë (Devoll)

Përsa i përket faqes së internetit të bashkisë, rreth 20% e të pyeturve mendojnë se nuk i përgjigjet kërkesave të qytetarëve apo nuk jep informacionin e kërkuar. Po t'i bashkangjitet këtij rezultati edhe 40% e të anketuarve që për arsye të tjera nuk merr informacion nga kjo faqe jemi në situatën ku më shumë se gjysma e të anketuarve nuk ka një mendim pozitiv mbi këtë instrument. Ndërsa rreth 40% e tyre mendon se kjo faqe jep informacion e duhur në kohën e duhur (figura 12).

“Pjesëmarrja e Publikut në Procesin e Vendimmarrjes Vendore”

Çfarë mendoni për faqen e internetit të bashkisë?

Answered: 92 Skipped: 8




Figura 12: Vlerësimi mbi faqen e internetit të Bashkisë (Devoll)

Duke bërë një përmbledhje të shkurtër të seksionit të informimit mund të themi se një pjesë e mirë e të anketuarve nuk janë në dijeni të instrumenteve që bashkia ofron për qytetarët apo edhe të prezencës së figurave profesionale. Edhe në rastin kur kanë njohuri për këto shërbime vlerësimi që japin për to nuk është nga më të lartët.

Seksioni i dytë i pyetësorit përmban pyetje mbi Këshillin Bashkiak.

Më tepër se 57% e qytetarëve nuk janë të informuar se cili anëtar i Këshillit përfaqëson lagjen/fshatin e tij (figura 13). Është me interes fakti se më shumë se gjysma e të intervistuarve nuk ka informacion lidhur me këtë instrument vendimmarrës dhe po të lexohet kjo e dhënë së bashku me përqindjen e atyre që duke qënë në dijeni të anëtarit që i përfaqëson komunikojnë me të lidhur me problemet që u interesojnë (figura 14), mund të konkludojmë se në momentin që kanë njohuri mbi përfaqësuesin e tyre në Këshill Bashkiak, qytetarët janë të prirur të përdorin këtë kanal për të influencuar vendimmarrjen për problemet e tyre (80%). Pra mungesa e informacionit sjell edhe institucione “larg” përfituesve të dretpërdrejtë.

A e dini se cili anëtar i Këshillit përfaqëson lagjen/fshatin tuaj?

Answered: 99 Skipped: 1




Figura 13: Cili anëtar ju përfaqëson në Këshillin Bashkiak (Devoll)

“Pjesëmarrja e Publikut në Procesin e Vendimmarrjes Vendore”

Nëse po, a komunikoni me anëtarin e Këshillit për problemet tuaja?

Answered: 40 Skipped: 60




Figura 14: Komunikimi me anëtarin/përfaqësues në Këshillin Bashkiak (Devoll)

Kur bëhet fjalë për të vlerësuar punën e kryer nga anëtarët e Këshillit Bashkiak, vetëm rreth 55% e të intervistuarve mendojnë se kjo i shërben komunitetit. Rreth 35% e tyre mendojnë se nuk i shërbejnë komunitetit apo i shërbejnë interesave të veta personale apo të të afërme të tyre (figura 15). Këto rezultate dëshmojnë mungesën e besimit të qytetarëve dhe shpjegon edhe skepticizmin në përdorimin e këtyre kanaleve për të influencuar në vendimmarrje.

Çfarë mendoni për punën që bëjnë anëtarët e Këshillit Bashkiak?

Answered: 98 Skipped: 2




Figura 15: Vlerësimi mbi punën e Këshillit Bashkiak (Devoll)

Seksioni i tretë i pyetësorit ka të bëjë me mbledhjet e Këshillit Bashkiak.

Rreth 57% e të intervistuarve nuk e dinë se këto mbledhje janë të hapura (figura 16). Pra vihet re mungesë e theksuar në informimin e qytetarëve mbi funksionimin e e organeve të vendimmarrjes dhe janë shumë të pakët ata që kanë informacion mbi rregullat dhe mundësitë që kanë vetë ata për të influencuar nëpërmjet pjesëmarrjes. Rreth 94% e tyre

“Pjesëmarrja e Publikut në Procesin e Vendimmarrjes Vendore”

nuk ka marrë pjesë asnjëherë në këto mbledhje (figura 17), ndërsa të pyetur përse ata do të donin të ishin pjesë e këtyre mbledhjeve, për 47% arsyeja është marrja e informacionit, ndërsa 47% të tjerë, kërkojnë që nëpërmjet pjesëmarrjes të mund të ndikojnë në vendimmarrje (figura 18).

A e dini që mbledhjet e Këshillit Bashkiak janë të hapura?

Answered: 99 Skipped: 1




Figura 16: Mbledhjet e Këshillit Bashkiak (Devoll)

A keni marrë pjesë ndonjëherë në takimet e hapura të Këshillit Bashkiak?

Answered: 96 Skipped: 4




Figura 17: Pjesëmarrja në mbledhjet e Këshillit Bashkiak (Devoll)

Vihet re se kur qytetarët janë të informuar, ata janë të interesuar të marrin pjesë në këto mbledhje. Përqindjet e larta të përgjigjeve dëshmojnë se ata janë të gatshëm të shprehin mendimet e tyre dhe të influencojnë vendimmarrjen (47%) dhe po kështu të informohen nëpërmjet pjesëmarrjes mbi problematikën dhe zgjidhjeve që u ofrohen nga drejtuesit lokal.

Përse mendoni se njerëzit mund të jenë të interesuar të marrin pjesë në takimet e hapura?

Answered: 99 Skipped: 1




Figura 18: Arsyet e pjesëmarrjes në takimet e hapura të Këshillit Bashkiak (Devoll)

“Pjesëmarrja e Publikut në Procesin e Vendimmarrjes Vendore”

Seksioni i katërt i pyetësorit lidhet me seancat e këshillimeve me bashkësinë.

Gati 55% e të anketuarve nuk janë në dijeni të faktit që Këshilli duhet të zhvillojë konsultime në komunitet para se të marrë vendime (figura 19).

Mungesa e informimit dhe transparencës ndikon negativisht në kontributin që qytetarët mund dhe duan të japin në komunitetin e tyre.

Siç mund të shohim nga tabela në vijim, më pak se 10% e tyre kanë marrë pjesë në një seancë këshillimi (figura 20). Arsyet për nivele kaq të ulëta pjesëmarrje variojnë: 23 % e të pyeturve e arsyetojnë mospjesëmarrjen e tyre me mungesën e besimit, ndërsa rreth 76% e tyre kanë motive të tjera (figura 21).

Nëse mungesës së informimit (45%) i bashkëngjitet edhe mungesa e besimit (23%) mund të pohojmë se seancat e këshillimit me bashkësinë nuk kanë funksionuar, apo nuk janë përdorur si instrument i garantimit të një vendimmarrje demokratike e pjesëmarrëse në bashkinë Devoll.

A e dini se para se këshilli të marrë vendime duhet që të zhvillohen konsultime me komunitetin?

Answered: 98 Skipped: 2




Figura 19: Informacion mbi seancat e këshillimeve me bashkësinë (Devoll)

A keni marrë pjesë në ndonjë seancë këshillimi?

Answered: 98 Skipped: 2




Figura 20: Pjesëmarrja në seancat e këshillimeve me bashkësinë (Devoll)

Nëse jo, pse?

Answered: 90 Skipped: 10




Figura 21: Arsyet e mospjesëmarrjes në seancat e këshillimeve me bashkësinë (Devoll)

Më shumë se gjysma e të intervistuarve do të ishte e interesuar të merrte pjesë në këto mbledhje kur diskutohet buxheti (rreth 35%) dhe kur vendoset për ndihmën ekonomike (më shumë se 25%). Kur vendoset për taksat dhe tatimet janë të interesuar rreth 20%, ndërsa kur bëhet fjalë për investimet në infrastrukturën e zonës janë të interesuar rreth 17% e të intervistuarve (figura 22).

Pra, vihet re se kur bëhet fjalë për çështje të cilat qytetarët i vlerësojnë si me interes dhe impakt të drejtpërdrejtë në jetën e përditshme, gatishmëria e tyre për pjesëmarrje është e lartë. 95 % e të anketuarve janë të gatshëm t’i dedikojnë kohë dhe energji kontributit për komunitetin.

Kur mund të ishit ju i interesuar të merrnit pjesë?

Answered: 100 Skipped: 0




Figura 22: Kur janë të interesuar te marrin pjesë në seancat e këshillimeve me bashkësinë (Devoll)

“Pjesëmarrja e Publikut në Procesin e Vendimmarrjes Vendore”

Vetëm 30% e të anketuarve janë në dijeni se komuniteti merr iniciativa dhe ia paraqet për vendim Këshillit Bashkiak dhe kanë marrë pjesë në këto iniciativa (figura 23).

70 % e të interesuarve, duke mos patur dijeni, mbetet jashtë përfshirjes në jetën politike të komunitetit, ndërkohë mospërdorimi i këtij instrumenti me shumë gjasa do të reflektojë dobësi në procesin vendimmarrës, institucione të shkëputura nga përfituesit e drejtëpërdrejtë, që janë vetë qytetarët.

A e dini që komuniteti merr iniciativa dhe ia paraqet për vendim Këshillit Bashkiak? Nëse po

Answered: 29 Skipped: 71




Figura 23: Pjesëmarrja në iniciativa të bashkësisë (Devoll)

Seksionin i pestë i pyetësorit analizon më nga afër pjesëmarrjen në organizimet komunitare: Këshilli Komunitar.

Më shumë se 80% e të anketuarve mendojnë se në zonën e tyre nuk ka një këshill të tillë (figura 24).

A ka në lagjen/zonën tuaj këshill komunitar?

Answered: 99 Skipped: 1




Figura 24: Pjesëmarrja në organizimet komunitare: Këshilli Komunitar (Devoll)

Pra pjesa më e madhe e qytetarëve nuk janë të informuar, por nëse pyeten mbi çfarë do donin të përfaqësonte ky Këshill, gati 95% e të intervistuarve shprehet se do të dëshironte që ky Këshill të përfaqësonte interesat e gjithë anëtarëve të komunitetit dhe vetëm 5% e tyre mendojnë se duhet të përfaqësojë interesat vetëm të anëtarëve (figura 25).

Çfarë do të dëshironit të përfaqësonite ky këshill komunitar?

Answered: 100 Skipped: 0




Tabela 25: Cfarë do donit të përfaqësonite Këshilli Komunitar? (Devoll)

Vetëm 35% e të intervistuarve do të merrnin pjesë në një Këshill të tillë për të marrë dhe dhënë informacion. Pjesa me e madhe e të intervistuarve do të dëshironite të përcillte problematikat e zonës (33%) dhe rreth 32% do të donte të ndikonte në zgjidhjen e këtyre problematikave (figura 26).

Pse mendoni se njerëzit duhet të marrin pjesë në këshill komunitar?

Answered: 100 Skipped: 0




Figura 26: Arsyet e pjesëmarrjes në Këshillin Komunitar (Devoll)

Një pjesë shume e madhe e të intervistuarve (rreth 85%) janë të gatshëm të marrin pjesë në takimet e organizuara nga këshilli komunitar dhe të diskutonin për problematikat që i shqetësojnë. Vetëm 5% shprehet se nuk ka kohë dhe më pak se 10% nuk kanë besim (figura 27).

“Pjesëmarrja e Publikut në Procesin e Vendimmarrjes Vendore”

Do të merrnit pjesë në takimet e organizuara nga këshilli komunitar për çështje që shqetësojnë banorët e lagjes tuaj?

Answered: 100 Skipped: 0




Figura 27: Gadishmëria për pjesëmarrje në organizimet komunitare: Këshilli Komunitar (Devoll)

Seksioni i gjashtë i pyetësorit paraqet qëndrimet e të intervistuarve lidhur me diskutimet në publik.

Më pak se 15 % e të intervistuarve nuk do t'i diskutonte problemet në publik për mungesë besimi apo pasi kanë vështirësi të flasin në publik. Rreth 36% do ta bënin diçka të tillë dhe rreth 50% duke shprehur gadishmërinë për të diskutuar ofron edhe komente mbi punën e bashkisë (figura 28).

Një pjesë e madhe e të intervistuarve (73%) do ta kritikonte punën e bashkisë në publik (figura 29).

Nëse pushteti vendor do të bënte një lajmërim dhe do t'iu kërkonte banorëve të mblidheshin për të diskutuar problemet e tyre në publik, a do ta kishit problem t'i diskutonit problemet tuaja para të tjerëve?

Answered: 100 Skipped: 0




Figura 28: Pjesëmarrja në diskutimet në publik (Devoll)

Nëse do t’u jepej mundësia, a do ta kritikoni punën e bashkisë në publik?

Answered: 99 Skipped: 1




Figura 29: Kritikat ndaj Bashkisë (Devoll)

3.3 Monitorimi i aktiviteteve të Bashkisë

Për të krijuar një panoramë të qartë të situatës në Bashkinë Devoll, gjatë periudhës MAJ – Shtator 2017, nga qendra ACEG u krye monitorimi i aktiviteteve dhe u mbledhën informacioni i nevojshëm lidhur me funksionimin e kësaj bashkie. Instrumenti i monitorimit ishte pyetësori, i strukturuar në katër tema kryesore: informacioni i përgjithshëm, transparencja e aktiviteteve, pjesëmarrja e publikut dhe baza ligjore dhe dokumentare.

Nga informacioni i mbledhur rezulton se bashkia zotëron jo vetëm faqe interneti, por edhe ambiente dhe figura profesionale që kanë si qëllim njoftimin e publikut dhe konsultimin e këtij të fundit.

Përsa i takon transparencën së aktiviteteve të bashkisë vihet re se përgjatë gjithë periudhës në shqyrtim ka një informacion të përditësuar lidhur me aktivitetet e bashkisë, por nuk ka asnjë informacion lidhur me zhvillimin e seancave të këshillimeve apo dëgjësave, as edhe mbi strukturat, adresat dhe kontaktet e bashkise.

Sportelet e informacionit nuk disponojnë hapësirë të mjaftueshme, ndonëse personeli nuk mungon. Ndërsa në muajin Korrik u vendosën edhe shenjat/tabelat që tregojnë ekzistencën e këtyre zyrave, që mungonin më parë.

Lidhur me pjesëmarrjen e publikut në seancën e këshillimeve me bashkësinë, vihet re mungesë e njoftimeve, ndërkohë që ambientet për të lejuar pjesëmarrjen e publikut nuk mungojnë.

Përsa i përket bazës ligjore dhe dokumentare nuk rezultojnë as regjistra të organizatave të shoqërisë civile apo grupeve të interesit, as iniciativa qytetare për marrjen e vendimeve nga Këshilli Bashkiak apo kryetari i bashkisë të regjistruara, ndonëse është miratuar nga bashkia një rregullore e pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje.

4. TË DHËNAT PËR BASHKINË PRRENJAS



4.1. Profili i Bashkisë

Prrenjasi kufizohet në veri me bashkinë Librazhd, në lindje me Republikën e Maqedonisë, në jug me Bashkinë Pogradec dhe në perëndim me Bashkinë Elbasan. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Prrenjasit.

Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2011, Prrenjasi ka një popullsi prej 24,906 banorësh. Ndërkohë që sipas Regjistrimit Civil, kjo bashki ka 33,031 banorë. Bashkia e re shtrihet në një sipërfaqe prej 322.95 km². Sipas censurit, densiteti i popullsisë është 77 banorë/km² ndërsa sipas regjistrimit civil densiteti është 102.279 banorë/km².

Kjo bashki përbëhet nga 4 njësi administrative, të cilat janë: Prrenjas, Qukës, Rrajcë dhe Stravaj. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e rrethit të Librazhdit dhe qarkut të Elbasanit. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 25 fshatra.

Bashkia e re e Prrenjasit përfshin sipërfaqe të shumta pyjore dhe burime të bollshme hidrike si dhe një fushë pjellore. Nëntoka është e pasur me krom, ndërkohë që ky mineral shfrytëzohet aktualisht në dy prej fshatrave të bashkisë së re.

Bashkia e re e Prrenjasit ka një pozicion të favorshëm gjeografik, pasi gjendet fare pranë dy pikave doganore me Maqedoninë. Por ky avantazh nuk është shfrytëzuar deri më sot për nxitjen e sipërmarrjes dhe shtimin e vendeve të punës.

Në të gjithë bashkinë e re rezultojnë të regjistruara 234 biznese, të cilat e kryejnë aktivitetin e tyre kryesisht në shërbime. Një pjesë e vogël e bizneseve merren me kultivimin e troftës.

Bashkia e Prrenjasit ka potenciale të pashfrytëzuara për turizëm natyror. Me historinë e pasur të zonës së Rrajcës, ku ndodhet shkëmbi i Skënderbeut dhe legjenda për Sofrën e tij si dhe me bukuritë natyrore të Sopotit, zona mund të kthehej në një destinacion për vizitorë vendas dhe të huaj.

Papunësia mbetet plaga kryesore për banorët e Prrenjasit dhe një sfidë për kryebashkiakun që u zgjodh më 21 Qershor. Investimet në fasoneri konsiderohen një mundësi e mirë për punësimin e grave të zonës, ndaj nxitja e bizneseve të kësaj fushe duhet të jetë një prioritet për mandatin 4-vjeçar.

Përmirësimi i godinave arsimore si dhe rehabilitimi i infrastrukturës rrugore të fshatrave konsiderohet një tjetër sfidë e rëndësishme për zhvillimin e bashkisë së re. Nga ana tjetër, qyteti vuan nga mungesa e ujit të pijshëm, nga ndriçimi i zonave publike dhe nga shërbimi i pastrimit, çështje që kërkojnë gjithashtu një administrim më të mirë.

Por edhe pse Prrenjasi ka probleme të shumta me punët publike, shoqëria civile vlerëson se detyra kryesore e bashkisë së re është mbrojtja e pyjeve dhe mirëadministrimi i aseteve minerare, në mënyrë që këto resurse të kthehen në të ardhura për buxhetin e bashkisë dhe komunitetin.²

4.2 Të dhënat e pyetësorëve për Bashkinë Prrenjas

Pyetësorit iu përgjigjen rreth 35% femra dhe 65% meshkuj, dhe rreth 30% e të intervistuarve i përkiste grupmoshës 30-50 vjeç, ndërsa rreth 35% u përkisnin repektivisht grupmoshave 18-30 vjeç dhe 27% mbi 50 vjeç. Profesionet e të intervistuarve ishin nga më të larmishmet, duke pasqyruar kështu edhe nivelin arsimor të tyre. Rreth 75% e të intervistuarve kishin arsim të mesëm e të lartë dhe rreth 25 % e tyre arsim të ulët (shih figurat 1, 2, 3.).

² <http://pushtetivendor.reporter.al/profili-i-bashkise-prrenjas/>

“Pjesëmarrja e Publikut në Procesin e Vendimmarrjes Vendore”

Gjinia?

Answered: 99 Skipped: 1




Figura 1: Gjinia (Prenjas)

Mosha?

Answered: 100 Skipped: 0




Figura 2: Mosha (Prenjas)

Arsimi?

Answered: 95 Skipped: 5




Figura 3: Arsimi (Prenjas)

Seksioni i parë i pyetësorëve ka të bëjë me informimin.

Pyetjes nëse qytetarët kanë paraqitur ndonjëherë kërkesë për informacion u është përgjigjur pozitivisht rreth 42% e popullsisë, ndërsa rreth 58% nuk kanë kërkuar ndonjëherë informacion në Bashki (shih Tabelën 4).

Fakti që një pjesë e madhe e qytetarëve paraqet një kërkesë të tillë dëshmon se kanalet e tjera të informimit nuk funksionojnë.

Ky fluks i madh kërkesash mund të shpjegojë dhe vonesat në përgjigjen që institucioni kthen, duke ulur kështu edhe cilësinë e shërbimeve ndaj komunitetit.

Keni paraqitur ndonjëherë kërkesë për informacion në bashki?

Answered: 100 Skipped: 0




Figura 4: Kërkesë për informim (Prrenjas)

Rreth 68% e të anketuarve të cilët kanë kërkuar informacion, nuk kanë marrë përgjigje në një kohë të shpejtë dhe janë rreth 32% e tyre që shprehen se kanë marrë këtë shërbim në kohë të arsyeshme (figura 5).

Ndërkohë vetëm rreth 37% e kanë marrë informacionin e kërkuar, kundrejt rreth 63% të të anketuarve të cilët nuk e kanë marrë këtë informacion (figura 6).

Siç mund të vihet re nga përgjigjet, të intervistuarit në pjesën më të madhe jo vetëm që nuk marrin shërbimet e informimit në kohë të arsyeshme, por edhe nuk e marrin këtë shërbim. Këto statistika dëshmojnë dobësitë në funksionimin aktual të strukturave të bashkisë Prrenjas.

Ju kanë kthyer përgjigje në një kohë të shpejtë?

Answered: 63 Skipped: 37




Figura 5: Informimi (Prrenjas)

A e keni marrë informacionin e kërkuar?

Answered: 62 Skipped: 38




Figura 6: Marrja e informacionit (Prenjas)

Rreth 17% e të anketuarve janë në dijeni te ekzistencës së një program transparence dhe të një koordinatori për transparencën e këtij institucioni (figura 7) dhe vetëm rreth 23% e dinë se ka një koordinator për njoftimin dhe konsultimin publik (figura 8).

Siç mund të vihet re, pjesa më e madhe e të interesuarve të drejtëpërdrejtë si përfitues të shërbimeve nuk kanë dijeni për këto instrumente.

Ashtu si në rastin e bashkisë Devoll, edhe në këtë bashki vihet re se ndonëse ekzistojnë programet dhe figurat profesionale që në teori sigurojnë transparencën dhe efijencën në funksionimin e institucionit, në praktikë qytetarët nuk informohen dhe siç do të shohim në vazhdim, sjell edhe nivele shumë të ulëta pjesëmarrjeje në vendim-marrje.

A e dini se në bashki ka një koordinator për transparencën e institucionit dhe një program transparence?

Answered: 100 Skipped: 0




Figura 7: Informimi i qytetarëve mbi programin dhe koordinatorit për transparencën (Prenjas)

“Pjesëmarrja e Publikut në Procesin e Vendimmarrjes Vendore”

A e dini se në bashki ka një koordinator për njoftimin dhe konsultimin publik?

Answered: 97 Skipped: 3




Figura 8: Informimi i qytetarëve mbi koordinatorin për njoftim dhe konsultim publik (Prrenjas)

Më shumë se 80% e të anketuarve nuk është në dijeni se bashkia e Prrenjasit ka një faqe interneti (figura 9) dhe rreth 18% e atyre që kanë njohuri marrin informacione nga kjo faqe (figura 10).

A e dini nëse bashkia juaj ka faqe interneti?

Answered: 99 Skipped: 1




Figura 9: Informimi mbi faqen e internetit (Prrenjas)

A merrni ndonjëherë informacion nga kjo faqe?

Answered: 48 Skipped: 52




Figura 10: Informacioni i marrë nga faqja e internetit (Prrenjas)

“Pjesëmarrja e Publikut në Procesin e Vendimmarrjes Vendore”

Përsa i përket punës së sportelit të informacionit, rreth 55% e të intervistuarve janë të pakënaqur nga ky shërbim, pasi mendojnë se nuk i përgjigjet kërkesave të të interesuarve (38%) dhe se nuk jep informacionin e duhur (rreth 17%) (figura 11).

Çfarë mendoni për punën e sportelit të informacionit?

Answered: 87 Skipped: 13




Figura 11: Vlerësimi për punën e sportelit të informacionit të Bashkisë (Prrenjas)

Të njëjtën pakënaqësi ndeshim edhe lidhur me faqen e internetit të bashkisë, ku rreth 90% e të anketuarve mendojnë se nuk u përgjigjet kërkesave të qytetarëve e nuk jep informacionin e kërkuar (figura 12).

Në një vështrim të përgjithshëm vihet re jo vetëm mungesë informimi dhe mangësi në funksionimin e strukturave përgjegjëse për këtë të fundit, por edhe pakënaqësi për cilësinë e shërbimeve të ofruara.

Çfarë mendoni për faqen e internetit të bashkisë?

Answered: 90 Skipped: 10




Figura 12: Vlerësimi mbi faqen e internetit të Bashkisë (Prrenjas)

Seksioni i dytë i pyetësorit përmban pyetje mbi Këshillin Bashkiak.

Rreth 63% e qytetarëve nuk janë të informuar se cili anëtar i Këshillit përfaqëson lagjen/fshatin e tij (figura 13) dhe vetëm rreth 30% e atyre që janë në dijeni komunikojnë me të lidhur me problemet që u interesojnë (figura 14).

A e dini se cili anëtar i Këshillit përfaqëson lagjen/fshatin tuaj?

Answered: 99 Skipped: 1




Figura 13: Cili anëtar ju përfaqëson në Këshillin Bashkiak (Prrenjas)

Vihet re se ndryshe nga rasti i bashkisë Devoll, ku njësoj ndesheshim me mungesë informacioni mbi anëtarin që i përfaqëson, njëherë që e kishin këtë informacion ishin të gatshëm të flisnin me të mbi problemet që i shqetësonin, në rastin e bashkisë Prrenjas, mbi 70% e të anketuarve nuk komunikojnë me këtë figurë.

Ndër arsytet që shpjegojnë këtë fenomen mund të përmenden mungesa e besimit të anëtarët e Këshillit dhe pakënaqësia për punën e zhvilluar nga këta të fundit, siç mund të shihet nga tabela në vijim.

Nëse po, a komunikoni me anëtarin e Këshillit për problemet tuaja?

Answered: 37 Skipped: 63




Figura 14: Komunikimi me anëtarin/përfaqësues në Këshillin Bashkiak (Prrenjas)

Vetëm rreth 13% e të anketuarve mendojnë se anëtarët e Këshillit Bashkiak bëjnë një punë që i shërben komunitetit, ndërsa pjesa tjetër mendon se nuk i shërben apo u shërben interesave të veta e të të afërme të tyre, duke reflektuar kështu mungesën e besimit të institucioni në fjalë (figura 15).

Çfarë mendoni për punën që bëjnë anëtarët e Këshillit Bashkiak?

Answered: 100 Skipped: 0




Figura 15: Vlerësimi mbi punën e Këshillit Bashkiak (Prenjas)

Seksioni i tretë i pyetësorit ka të bëjë me mbledhjet e Këshillit Bashkiak.

Rreth 28% e të intervistuarve nuk e dinë se këto mbledhje janë të hapura (figura 16), pra krahasuar me rastin e bashkisë Devoll, qytetarët janë më të informuar, por rreth 97% e tyre nuk ka marrë pjesë në këto mbledhje (figura 17).

Nivele kaq të ulëta pjesëmarrje dëshmojnë një frymë mosbesimi në funksionimin e strukturave vendimmarrëse.

Për më tepër, ata do e shihnin pjesëmarrjen e tyre në këto mbledhje më shumë si një rast të mirë për marrje informacioni, (77%), ndërsa vetëm 22% kërkon nëpërmjet pjesëmarrjes të ndikojë në vendimmarrje (figura 18). Këto shifra dëshmojnë paqartësinë e qytetarëve lidhur me funksionimin dhe detyrat e organeve të bashkisë, duke humbur kështu rastin e shfrytëzimit të tyre në dobi të interesave të komunitetit.

A e dini që mbledhjet e Këshillit Bashkiak janë të hapura?

Answered: 100 Skipped: 0




Figura 16: Mbledhjet e Këshillit Bashkiak (Prenjas)

“Pjesëmarrja e Publikut në Procesin e Vendimmarrjes Vendore”

A keni marrë pjesë ndonjëherë në takimet e hapura të Këshillit Bashkiak?

Answered: 100 Skipped: 0




Figura 17: Pjesëmarrja në takimet e hapura të Këshillit Bashkiak (Prrenjas)

Përse mendoni se njerëzit mund të jenë të interesuar të marrin pjesë në takimet e hapura?

Answered: 100 Skipped: 0




Figura 18: Arsyet e pjesëmarrjes në takimet e Këshillit Bashkiak (Prrenjas)

Seksioni i katërt i pyetësorit lidhet me seancat e këshillimeve me bashkësinë.

Ashtu si në seksionin më sipër, edhe për sa i takon vlerësimin që qytetarët kanë mbi mundësinë për të ndikuar vendimmarrjen, vihet re pasivitet në pjesëmarrje dhe reflektohet përsëri mungesë besimi.

Të dyja këto janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën dhe influencojnë negativisht duke krijuar një rreth vicioz: mungesë besimi - pjesëmarrje e ulët - cilësi e ulët demokratike.

Gati 62% e të anketuarve janë në dijeni të faktit që Këshilli duhet të zhvillojë konsultime në komunitet para se të marrë vendime (figura 19), por vetëm 3% e tyre kanë marrë pjesë në një seancë këshillimi (figura 20). Rreth 70 % e të pyeturve e arsyetojnë mospjesëmarrjen e tyre me mungesën e besimit, ndërsa pjesa tjetër kanë motive të tjera (figura 21).

“Pjesëmarrja e Publikut në Procesin e Vendimmarrjes Vendore”

A e dini se para se këshilli të marrë vendime duhet që të zhvillohen konsultime me komunitetin?

Answered: 100 Skipped: 0




Figura 19: Informacion mbi seancat e këshillimeve me bashkësinë (Prrenjas)

A keni marrë pjesë në ndonjë seancë këshillimi?

Answered: 99 Skipped: 1




Figura 20: Pjesëmarrja në seancat e këshillimeve me bashkësinë (Prrenjas)

Nëse jo, pse?

Answered: 94 Skipped: 6




Figura 21: Arsyet e mospjesëmarrjes në seancat e këshillimeve me bashkësinë (Prrenjas)

Rreth 35% e të anketuarve do të ishin të interesuar të ishin të pranishëm kur hartohet buxheti dhe në të njëjtën masë edhe kur vendoset për ndihmën ekonomike. Rreth 16%

“Pjesëmarrja e Publikut në Procesin e Vendimmarrjes Vendore”

duan të jenë të pranishëm kur vendoset për taksat dhe 14% kur vendoset për investimet në infrastrukturën e zonës (figura 22).

Vihet re se për motive të ndryshme, të gjithë të interesuarit janë të gatshëm të marrin pjesë në këto mbledhje, duke kërkuar kështu transparencën e institucionit dhe vendimmarrjes.

Kur mund të ishit ju i interesuar të merrnit pjesë?

Answered: 100 Skipped: 0




Figura 22: Kur janë të interesuar të marrin pjesë në seancat e këshillimeve me bashkësinë (Prrenjas)

Vetëm 7% e të anketuarve janë në dijeni të faktit që komuniteti merr iniciativa dhe ia paraqet për vendim Këshillit Bashkiak dhe kanë marrë pjesë në këto iniciativa (figura 23). Mungesa e theksuar e informacionit ka si pasojë humbjen e mundësisë për të përdorur këtë mekanizëm, i nevojshëm për të zbutur distancën politikëbërës - qytetar. Në këtë rast, është shumë evidente nevoja e menjëhershme për të informuar komunitetin mbi instrumentet që kanë në dispozicion dhe mund të përdorin për të sjellë “zërin” e tyre.

Fakti që ata që janë të interesuar, apo që kanë qenë edhe pjesëmarrës në iniciativa, dëshmon që interesimi dhe angazhimi qytetar nuk mungon.

A e dini që komuniteti merr iniciativa dhe ia paraqet për vendim Këshillit Bashkiak? Nëse po

Answered: 7 Skipped: 93




Figura 23: Pjesëmarrja në iniciativa të Bashkisë (Prrenjas)

Seksionin i pestë i pyetësorit hedh dritë mbi pjesëmarrjen në organizimet komunitare: Këshilli Komunitar.

Rreth 67% e të anketuarve janë me dije se në zonën e tyre ka një këshill të tillë (figura 24). Pra në këtë rast, ndeshim një nivel më të lartë informimi se në rastin e iniciativave qytetare. Është interesant fakti se gati të gjithë të anketuarve e shohin këtë këshill si përfaqësues të interesave të të gjithë komunitetit dhe arsyet që do shtynin ata të merrnin pjesë në pjesën më të madhe kanë të bëjnë me tematika të përgjithshme dhe më pak për marrje informacioni (shih tabelat në vijim).

A ka në lagjen/zonën tuaj këshill komunitar?

Answered: 100 Skipped: 0




Figura 24: Informacion mbi Këshillin Komunitar (Prrenjas)

Rreth 93% e të intervistuarve do të donte që ky këshill të përfaqësonte interesat e të gjithë qytetarëve (figura 25).

Çfarë do të dëshironit të përfaqësonte ky këshill komunitar?

Answered: 100 Skipped: 0




Figura 25: Çfarë do donit të përfaqësonte Këshilli Komunitar (Prrenjas)?

Një pjesë e konsiderueshme e të anketuarve (35%) mendojnë se duke marrë pjesë në një këshill komunitar përcjellin problematikën e komunitetit dhe ndikojnë në zgjidhjen e tyre (33%), ndërsa rreth 32% e shohin si mënyrë për të marrë dhe dhënë informacion (figura 26).

“Pjesëmarrja e Publikut në Procesin e Vendimmarrjes Vendore”

Vihet re se arsyet e pjesëmarrjes dhe përqindjet janë shumë të ngjashme me ato të bashkisë Devoll. Pjesa më e madhe dëshiron të përcjellë dhe të zgjidhë problematikat e komunitetit dhe në masë më të vogël ta përdorë si mundësi për t’u informuar.

Pse mendoni se njerëzit duhet të marrin pjesë në këshill komunitar?

Answered: 100 Skipped: 0




Figura 26: Arsyet e pjesëmarrjes në Këshillin Komunitar (Prrrenjas)

Kjo gatishmëri dëshmohej edhe nga përgjigjet e pyetjes në vijim. Më shumë se 80% e të intervistuarve shprehet e gatshme të marrë pjesë në takimet e organizuara nga Këshilli Komunitar për të diskutuar mbi çështjet që shqetësojnë komunitarët, dhe rreth respektivisht 6% shprehet se nuk ka kohë apo besim të marrë pjesë (figura 27).

Do të merrnit pjesë në takimet e organizuara nga këshilli komunitar për çështje që shqetësojnë banorët e lagjes tuaj?

Answered: 100 Skipped: 0




Figura 27: Gadishmëria për pjesëmarrje në organizimet komunitare: Këshilli Komunitar (Prrrenjas)

“Pjesëmarrja e Publikut në Procesin e Vendimmarrjes Vendore”

Qytetarët e intervistuar, si në Prrenjas ashtu edhe në Devoll janë të gatshëm të marrin pjesë në organizimet komunitare dhe besimi i tyre në këtë instrument është shumë më i lartë se në organet e tjera (vetëm 6-7% e arsyejnë mospjesëmarrjen me mungesë besimi).

Seksioni i fundit i pyetësorit ka të bëjë me diskutimet në publik.

Rreth 60% e të anketuarve shprehen të gatshëm të diskutojnë problemet e tyre në publik dhe vetëm 12% shprehen se kanë problem të flasin në publik. Është interesant fakti se, rreth 22% nuk kanë besim se prania e tyre do të ndryshonte ndonjë gjë (figura 28) dhe rreth 85% e të anketuarve do të ishin të gatshëm të kritikonin punën e bashkisë në publik (figura 29).

Nëse pushteti vendor do të bënte një lajmërim dhe do t’iu kërkonte banorëve të mblidheshin për të diskutuar problemet e tyre në publik, a do ta kishit problem t’i diskutonit problemet tuaja para të tjerëve?

Answered: 98 Skipped: 2




Figura 28: Pjesëmarrja në diskutimet në publik (Prrenjas)

Nëse do t’u jepej mundësia, a do ta kritikonit punën e bashkisë në publik?

Answered: 100 Skipped: 0




Figura 29: Kritikat ndaj Bashkisë (Prrenjas)

4.3 Monitorimi i aktiviteteve të Bashkisë Prrenjas

Për të krijuar një panoramë të qartë të situatës në Bashkinë Prrenjas, gjatë periudhës Maj – Shtator 2017, nga shoqata Egnantia u krye monitorimi i aktiviteteve dhe u mbledh informacioni i nevojshëm lidhur me funksionimin e kësaj bashkie. Instrumenti i monitorimit ishte pyetësori, i strukturuar në katër tema kryesore: informacion i përgjithshëm, transparencën e aktiviteteve, pjesëmarrjen e publikut dhe bazën ligjore dhe dokumentare.

Nga informacioni i mbledhur rezultoi se bashkia zotëron një faqe interneti e cila nuk është gjithmonë e aksesueshme. Ambiente dhe figura profesionale që kanë si qëllim njoftimin e publikut dhe konsultimin e këtij të fundit nuk mungojnë.

Përsa i takon transparencën së aktiviteteve të bashkisë, vihet re se përgjatë gjithë periudhës në shqyrtim ka një informacion të përditësuar lidhur me aktivitetet e bashkisë atëherë kur faqja e internetit është e aksesueshme, por nuk ka asnjë informacion lidhur me zhvillimin e seancave të këshillimeve apo dëgjësive, as edhe mbi strukturat, adresat dhe kontaktet e bashkisë. Për të njëjtën arsye (aksesi), mungojnë njoftimet lidhur me mbledhjet e këshillit bashkiak.

Sportelet e informacionit dispojnë hapësirë të mjaftueshme dhe personeli nuk mungon. Shenjat/tabelat që tregojnë ekzistencën e këtyre zyrave janë të pranishme.

Përsa i përket bazës ligjore dhe dokumentare nuk rezultojnë iniciativa qytetare për marrjen e vendimeve nga Këshilli Bashkiak apo kryetari i bashkisë të regjistruara përgjatë muajve Qershor dhe Korrik (në fund të muajit Korrik ka të tilla), ndonëse është miratuar nga bashkia një rregullore e pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje. Ka regjistra të organizatave të shoqërisë civile dhe grupeve të interesit.

Interesi qytetar për të qënë pjesëmarrës në vendimmarrje nuk gjen përgjigje nga institucioni, i cili me mungesën e transparencës shkakton mungesë besimi dhe informacioni.

5. TË DHËNAT PËR BASHKINË LIBOHOVË



5.1 Profili i Bashkisë

Libohova kufizohet në veri me bashkinë Këlcyrë, në lindje me Bashkinë Përmet, në jug me bashkinë Dropull dhe në perëndim me bashkinë Gjirokastër. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Libohovës.

Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2011 ka një popullsi prej 3.667 banorësh. Ndërkohë që sipas Regjistrimit Civil, kjo bashki ka 7.158 banorë. Libohova shtrihet në një sipërfaqe prej 248.24 km² me një densitet prej 28.83 banorë/km².

Kjo bashki përbëhet nga 3 njësi administrative, të cilat janë: Libohovë, Qendër Libohovë dhe Zagorie. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e rrethit Gjirokastër dhe e qarkut Gjirokastër. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 17 fshatra.

Bashkia Libohovë ka qenë që prej vitit 1914 nënprefekturë. Zona që përfshihet në bashkinë e re është e pasur me monumente arkeologjike, historike, monumente kulti dhe natyrore, me vlera unike në llojin e vet, të vizitueshme në çdo kohë dhe të njohura ndërkombëtarisht.

Gjatë 20 viteve të fundit, popullsia e Libohovës ka njohur nivel të ulët të rritjes demografike, edhe pse emigrimi apo migrimi ka shënuar ulje të ndjeshme. Kjo zonë është në proces gjenerimi dhe ofron mundësi punësimi, përqendrimi, investimi, turizmi, duke premtuar përmirësim të jetës së banorëve.

Bashkia e re e Libohovës ka nevojë për investime në infrastrukturë, ekonomi, turizëm, bujqësi e blegtori, pasi është një nga zonat më të rëndësishme për numrin e bagëtive të imta dhe sipërfaqes bujqësore. Libohova mban rekord në Shqipëri për shumëllojshmërinë e bimëve medicinale. Pozicioni gjeografik e bën Libohovën një qendër potenciale, duke u bashkuar me zonat e tjera përreth si komunën Qendër- Libohovë apo komunën Zagorie. Ajo mund të ofrojë një shërbim më të mirë si qendër bashkie, duke shfrytëzuar potencialet hidrike, bujqësore, blegtorale dhe turistike të të gjithë zonës.

Pozicioni gjeografik kufitar, pjesëmarrja aktive në projektin IPA për zhvillimin e zonave ndërkufitare, projektet e përbashkëta për eko-turizmin me bashkinë e Zagorit, Greqi, do të sillnin një hop cilësor për këtë zonë, duke përfituar nga shkëmbimi ekonomik dhe social –kulturor.

Administrimi i të ardhurave nga bujqësia, nga blegtoria, fuqizimi dhe nxitja e bizneseve dhe promovimi i produkteve të zonës mbeten sfida për t’u përballuar nga bashkia e re e Libohovës.

Trashëgimia e pasur historike dhe kulturore krijon premiset e zhvillimit të agroturizmit në këtë zonë, por cilësia e keqe e rrugëve lidhëse mes Libohovës dhe fshatrave që e rrethojnë e vështirëson këtë mundësi.

Në këtë drejtim, shumë objekte të trashëgimisë kulturore mbeten të paarrtshme për turistët potencialë.

Bashkia duhet të përcaktojë një strategji afatshkurtër se si do zhvillohen disa nga zonat me potenciale turistike, përfshi dhe vetë qytetin si dhe të projektojë mbështetjen e zonave më të thella si ajo e Zagorisë. Një sfidë është zhvillimi i markës së prodhimeve blegtorale të Libohovës, sidomos i djathit, që njihet në gjithë Shqipërinë. Bashkia do duhet të nxisë projekte që mundësojnë në të ardhmen eksportin e këtyre produkteve në Bashkimin Europian.

Restaurimi i Kalasë së Libohovës dhe disa monumenteve historike mbetet një tjetër sfidë për bashkinë e re, që së bashku me sarajet e bejlerëve të Libohovës mund të kthehen në atraksione turistike të periudhës osmane.

Zhvillimi i arsimit mbetet një sfidë sidomos në zonat ku ka pak nxënës dhe kryhet mësim i kombinuar³.

5.2 Të dhënat e pyetësorëve për Bashkinë Libohovë

Në rastin e bashkisë Libohovë, rreth 49% e të anketuarve që u janë përgjigjur pyetjeve janë femra dhe 51% meshkuj (figura 1), në masën 37% të moshës 30-50 vjeç, rreth 35%

të moshës mbi 50 vjeç dhe 25% të moshës 18-30 vjeç (figura 2). Pjesa më e madhe e të anketuarve janë me arsim të mesëm (rreth 47 %) dhe pjesa tjetër gati në të njëjtën masë i përket arsimit të ulët dhe të lartë (figura 3).

Gjinia?

Answered: 100 Skipped: 0




Figura 1. Gjinia (Libohovë)

Mosha?

Answered: 100 Skipped: 0




Figura 2. Mosha (Libohovë)

³ <http://pushtetivendor.reporter.al/profil-i-bashkise-libohove/>

Arsimi?

Answered: 100 Skipped: 0




Figura 3. Arsimi (Libohovë)

Seksioni i parë i pyetësorëve ka të bëjë me informimin. Pyetjes nëse qytetarët kanë paraqitur ndonjëherë kërkesë për informacion u është përgjigjur pozitivisht 70% e popullsisë, ndërsa rreth 30% nuk kanë kërkuar ndonjëherë informacion (shih figurën 4).

Keni paraqitur ndonjëherë kërkesë për informacion në bashki?

Answered: 100 Skipped: 0




Figura 4. Kërkesë për informacion (Libohovë)

Nga të interesuarit për të marrë informacion rreth 80% deklaron se ka marrë përgjigje në një kohë të shpejtë dhe rreth 78% që e ka marrë informacionin e duhur (figurat 5, 6).

Pjesa tjetër shprehin pakënaqësinë e tyre si për mosmarrjen e shërbimit të kërkuar, ashtu edhe për kohën e gjatë të pritjes.

Krahasuar me bashkitë Devoll dhe Prrenjas, duket se niveli i pakënaqësisë është më i ulët, por gjithsesi rreth 40% e atyre që kanë kërkuar shërbimin janë të pakënaqur.

“Pjesëmarrja e Publikut në Procesin e Vendimmarrjes Vendore”

Ju kanë kthyer përgjigje në një kohë të shpejtë?

Answered: 71 Skipped: 29




Figura 5. Informimi (Libohovë)

A e keni marrë informacionin e kërkuar?

Answered: 71 Skipped: 29




Figura 6. Marrja e informacionit (Libohovë)

Rreth 78% e të anketuarve janë në dijeni të ekzistencës së një koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik, ndërkohë që gati 90% nuk ka informacion as mbi figurën e koordinorit dhe as të programit të transparencës (figurat 7, 8).

A e dini se në bashki ka një koordinator për njoftimin dhe konsultimin publik?

Answered: 100 Skipped: 0




Figura 7. Informimi i qytetarëve mbi koordinatorin për njoftimin dhe konsultimin publik (Libohovë)

“Pjesëmarrja e Publikut në Procesin e Vendimmarrjes Vendore”

A e dini se në bashki ka një koordinator për transparencën e institucionit dhe një program transparence?

Answered: 95 Skipped: 5




Figura 8. Informimi i qytetarëve mbi programin dhe koordinatorit për transparencën (Libohovë)

A e dini nëse bashkia juaj ka faqe interneti?

Answered: 100 Skipped: 0




Figura 9. Informimi mbi faqen e internetit (Libohovë)

Ndërkohë gati 93% e të intervistuarve kur pyeten lidhur me çfarë mendojnë për faqen e internetit përgjigjen tjetër.

Çfarë mendoni për faqen e internetit të bashkisë?

Answered: 98 Skipped: 2




Figura 10. Vlerësimi mbi faqen e internetit (Libohovë)

Siç vihet re nga përgjigjet e të intervistuarve mungesa e faqes së internetit të bashkisë Libohovë e bën atë një mjet informimi të papërdorshëm. Ai që konsiderohet si një kanal i thjeshtë në përdorim, i aksesueshëm nga vendndodhje të ndryshme fizike, i shpejtë dhe

interaktiv është një mjet i pashfrytëzuar në këtë bashki.

Nevojën për informacion qytetarët e përmbushin duke iu drejtuar sporteleve të informacionit.

A merrni ndonjëherë informacion nga kjo faqe?

Answered: 99

Skipped: 1




Figura 11: Informacioni i marrë nga faqja e internetit (Libohovë)

68% e të intervistuarve shprehen të kënaqur nga puna e sportelit dhe shprehen se marrin informacionin e kërkuar, ndërsa janë 11% e tyre që shprehen se nuk e marrin këtë informacion, apo janë të pakënaqur me shërbimin (figura 12).

Çfarë mendoni për punën e sportelit të informacionit?

Answered: 100

Skipped: 0




Figura 12. Vlerësimi për punën e sportelit të informacionit (Libohovë)

Seksioni i dytë i pyetësorit përmban pyetje mbi Këshillin Bashkiak.

Rreth 67% e qytetarëve nuk janë të informuar se cili anëtar i Këshillit përfaqëson lagjen/ fshatin e tij (figura 13), por është interesant fakti se në rastin e atyre që e dinë, më shumë se 90% e tyre komunikojnë me të lidhur me problemet që u interesojnë (figura 14).

Rasti i Libohovës është shumë i ngjashëm me atë të Devollit. Më tepër se gjysma e të intervistuarve nuk ka informacion lidhur me këtë instrument vendimmarrës dhe po të lexohet kjo e dhënë së bashku me përqindjen e atyre që duke qënë në dijeni të anëtarit që i përfaqëson komunikojnë me të lidhur me problemet që u interesojnë (90%), mund të konkludojmë se në momentin që kanë njohuri mbi përfaqësuesin e tyre në Këshill Bashkiak, qytetarët janë të prirur të përdorin këtë kanal për të influencuar vendim-marrjen për problemet e tyre. Pra, mungesa e informacionit sjell edhe mospërdorimin e instrumenteve dhe mekanizmave përfaqësues.

“Pjesëmarrja e Publikut në Procesin e Vendimmarrjes Vendore”

A e dini se cili anëtar i Këshillit përfaqëson lagjen/fshatin tuaj?

Answered: 100 Skipped: 0




Figura 13. Cili anëtar ju përfaqëson në Këshillin Bashkiak (Libohovë)

Nëse po, a komunikoni me anëtarin e Këshillit për problemet tuaja?

Answered: 37 Skipped: 63




Figura 14. Komunikimi me anëtarin/përfaqësuesin në Këshillin Bashkiak (Libohovë)

Rreth 43% e të anketuarve vlerësojnë punën e anëtarëve të Këshillit dhe mendojnë se i shërben interesave të komunitetit, rreth 30% mendon se i shërben interesave vetjake dhe të të afërmeve të tyre dhe rreth 12% mendon se nuk i shërbejnë interesave të komunitetit. Niveli i besimit të qytetarëve është i ulët, ashtu si në bashkitë Devoll dhe Prrenjas. Një pjesë jo e vogël mendojnë se interesat personale dhe favorët vijnë para interesave të komunitetit (42%) (figura 15).

Çfarë mendoni për punën që bëjnë anëtarët e Këshillit Bashkiak?

Answered: 100 Skipped: 0




Figura 15. Vlerësimi mbi punën e anëtarëve të Këshillit Bashkiak (Libohovë)

Seksioni i tretë i pyetësorit ka të bëjë me mbledhjet e Këshillit Bashkiak.

Rreth 43% e të intervistuarve nuk janë në dijenise këto mbledhje janë të hapura (figura 16).

Në fakt mbi 90% e tyre nuk kanë marrë ndonjëherë pjesë në këto takime. Nëse pyeten mbi arsyet pse qytetarët janë të interesuar të marrin pjesë në këto mbledhje, përgjigjet e tyre janë si vijon: arsyeja e pjesëmarrjes për 52% është marrja e informacionit, ndërsa 36% kërkon nëpërmjet pjesëmarrjes të ndikojë në vendimmarrje (figura 17).

Këto statistika tregojnë se në mungesë të informacionit nga burime të tjera, mbledhjet e Këshillit Bashkiak shihen më shumë si mundësi informimi se sa si mjet për të influencuar mbi politikat vendore dhe për të ndikuar në vendim-marrje.

A e dini që mbledhjet e Këshillit Bashkiak janë të hapura?

Answered: 100 Skipped: 0




Figura 16. Informimi mbi mbledhjet e Këshillit Bashkiak (Libohovë)

Pjesa dërmuese e të anketuarve deklarojnë se nuk kanë marrë pjesë ndonjëherë në takimet e hapura të Këshillit Bashkiak (92%) (figura 17).

“Pjesëmarrja e Publikut në Procesin e Vendimmarrjes Vendore”

A keni marrë pjesë ndonjëherë në takimet e hapura të Këshillit Bashkiak?

Answered: 100 Skipped: 0




Figura 17. Pjesëmarrja në takimet e hapura të Këshillit Bashkiak (Libohovë)

Përse mendoni se njerëzit mund të jenë të interesuar të marrin pjesë në takimet e hapura?

Answered: 100 Skipped: 0




Figura 18. Arsyet e pjesëmarrjes në mbledhjet e Këshillit Bashkiak (Libohovë)

Seksioni i katërt i pyetësorit lidhet me seancat e këshillimeve me bashkësinë.

Gati 57% e të anketuarve janë në dijeni të faktit që Këshilli duhet të zhvillojë konsultime në komunitet para se të marrë vendime (figura 19). Mungesa e informimit dhe transparencës ndikon negativisht në kontributin që qytetarët mund dhe duan të japin në komunitetin e tyre. Vetëm 16% e tyre kanë marrë pjesë në një seancë këshillimi (figura 20). Arsyet për nivele kaq të ulëta pjesëmarrje variojnë: rreth 10% e të pyeturve e arsyetojnë mospjesëmarrjen e tyre me mungesën e besimit, ndërsa pjesa tjetër kanë motive të tjera (figura 21).

Nëse mungesës së informimit (43%) i bashkangjitet edhe mungesa e besimit (10%), mund të pohojmë se seancat e këshillimit me bashkësinë nuk kanë funksionuar, apo nuk janë përdorur si instrument i garantimit të një vendimmarrje demokratike e pjesëmarrëse në bashkinë Libohovë.

Situata në Libohovë duket shumë e ngjashme me atë në dy bashkitë e tjera.

A e dini se para se këshilli të marrë vendime duhet që të zhvillohen konsultime me komunitetin?

Answered: 100 Skipped: 0




Figura 19. Informacion mbi seancat e këshillimeve me bashkësinë (Libohovë)

“Pjesëmarrja e Publikut në Procesin e Vendimmarrjes Vendore”

A keni marrë pjesë në ndonjë seancë këshillimi?

Answered: 99 Skipped: 1




Figura 20. Pjesëmarrja në seanca këshillimi (Libohovë).

Nëse jo, pse?

Answered: 84 Skipped: 16




Figura 21: Arsyet e mospjesëmarrjes në seanca këshillimi (Libohovë)

Rreth 39% e të intervistuarve do të ishte e interesuar të merrte pjesë në këto mbledhje kur diskutohet buxheti dhe rreth 12% kur vendoset për ndihmën ekonomike, kur vendoset për taksat dhe tatimet janë të interesuar rreth 22%, ndërsa kur bëhet fjalë për investimet në infrastrukturën e zonës janë të interesuar rreth 20% e të intervistuarve.

Kur mund të ishit ju i interesuar të merrnit pjesë?

Answered: 100 Skipped: 0




Figura 22. Arsyet e pjesëmarrjes në mbledhjet e Këshillit Bashkiak (Libohovë)

“Pjesëmarrja e Publikut në Procesin e Vendimmarrjes Vendore”

Nga 67% e të intervistuarve që deklarojnë se janë në dijeni të faktit se komuniteti mund të marrë iniciativa dhe t’ia paraqesë për miratim Këshillit Bashkiak, të gjithë deklarojnë të kenë qënë pjesë e iniciativave të tilla (figura 23).

A e dini që komuniteti merr iniciativa dhe ia paraqet për vendim Këshillit Bashkiak? Nëse po

Answered: 67 Skipped: 33




Figura 23. Informimi mbi iniciativat e komunitetit (Libohovë)

Seksionin i pestë i pyetësorit lidhet me pjesëmarrjen në organizimet komunitare: Këshilli Komunitar.

Rreth 84% e të anketuarve nuk janë në dijeni se në zonën e tyre ka një këshill të tillë (figura 24), dhe më shumë se 90% do të dëshironte që ky këshill të përfaqësonte interesin e gjithë qytetarëve, dhe vetëm 6% mendon se duhet të paraqesë interesat e bashkisë (figura 25).

Ajo që bie në sy është mungesa e informimit mbi këshillin komunitar, ashtu si edhe në dy bashkitë e tjera.

A ka në lagjen/zonën tuaj këshill komunitar?

Answered: 100 Skipped: 0




Figura 24. Informacion mbi Këshillin Komunitar (Libohovë)

Çfarë do të dëshironit të përfaqësonite ky këshill komunitar?

Answered: 99 Skipped: 1




Figura 25. Cilat interesa do donit të përfaqësonite këshilli komunitar (Libohovë)

Pse mendoni se njerëzit duhet të marrin pjesë në këshill komunitar?

Answered: 100 Skipped: 0




Figura 26. Arsyet e pjesëmarrjes në këshillin komunitar (Libohovë)

Rreth 50% e të intervistuarve mendojnë se pjesëmarrja e tyre në këshill do të ndikonte në zgjidhjen e problemeve të komunitetit, ndërsa 33% mendojnë se shërben për të përcjellë problematikën dhe 17% për të dhënë e marrë informacion.

Pjesa më e madhe e të anketuarve shprehet e gatshme të marrë pjesë e të diskutojë në takimet e organizuara nga këshilli komunitar, për të diskutuar mbi çështjet që shqetësojnë banorët. 10% shprehet se nuk ka besim dhe rreth 6% deklaron se nuk ka kohë.

“Pjesëmarrja e Publikut në Procesin e Vendimmarrjes Vendore”

Nëse pushteti vendor do të bënte një lajmërim dhe do t’iu kërkonte banorëve të mblidheshin për të diskutuar problemet e tyre në publik, a do ta kishit problem t’i diskutonit problemet tuaja para të tjerëve?

Answered: 57 Skipped: 43




Figura 27. Gadishmëria për pjesëmarrje në takimet e këshillit komunitar (Libohovë)

Përsa i takon seksionit të gjashtë, diskutimeve në publik, rreth 70% e atyre që do të mblidheshin për të diskutuar do të ishte e gatshme të diskutonte problemet para të tjerëve, 10% nuk ka besim dhe rreth 15% ka vështirësi të flasë në publik (figura 28).

Rreth 67% e të anketuarve shpreh gatishmërinë për të kritikuar punën e bashkisë në publik nëse do i jepej rasti (figura 29).

Do të merrnit pjesë në takimet e organizuara nga këshilli komunitar për çështje që shqetësojnë banorët e lagjes tuaj?

Answered: 100 Skipped: 0




Figura 28. Pjesëmarrja në diskutimet në publik (Libohovë)

Nëse do t’u jepej mundësia, a do ta kritikoni punën e bashkisë në publik?

Answered: 100 Skipped: 0




Figura 29. Kritikat për Bashkinë (Libohovë)

5.3 Monitorimi i aktiviteteve të Bashkisë Libohovë

Për të krijuar një panoramë të qartë të situatës në Bashkinë Libohovë, gjatë periudhës Maj –Shtator 2017, nga Fondacioni SMR u krye monitorimi i aktiviteteve dhe u mbledh informacioni i nevojshëm lidhur me funksionimin e kësaj bashkie. Instrumenti i monitorimit ishte pyetësi, i strukturuar në katër tema kryesore: informacioni i përgjithshëm, transparencën e aktiviteteve, pjesëmarrjen e publikut dhe bazën ligjore dhe dokumentare. Nga informacioni i mbledhur rezulton se bashkia nuk zotëron një faqe interneti. Ambiente dhe figura profesionale që kanë si qëllim njoftimin e publikut dhe konsultimin e këtij të fundit nuk mungojnë.

Përsa i takon transparencës së aktiviteteve të bashkisë, vihet re se përgjatë gjithë periudhës në shqyrtim nuk ka një informacion të përditësuar lidhur me aktivitetet e bashkisë, meqenëse faja e internetit nuk ekziston. Për të njëjtën arsye nuk ka asnjë informacion lidhur me zhvillimin e seancave të këshillimeve apo dëgjësive, as edhe mbi strukturat, adresat dhe kontaktet e bashkise dhe njoftimet lidhur me mbledhjet e këshillit bashkiak.

Sportelet e informacionit dispojnë hapësirë të mjaftueshme dhe personeli nuk mungon. Shenjat/tabelat që tregojnë ekzistencën e këtyre zyrave nuk janë të pranishme.

Lidhur me pjesëmarrjen e publikut në seancën e këshillimeve me bashkësinë vihet re mungesë e njoftimeve dhe ambientet për të lejuar pjesëmarrjen e publikut mungojnë.

Përsa i përket bazës ligjore dhe dokumentare nuk rezultojnë iniciativa qytetare për marrjen e vendimeve nga Këshilli Bashkiak apo kryetari i bashkisë të regjistruara, dhe nuk është miratuar nga bashkia një rregullore e pjesëmarrjes së publikut në vendim-marrje. Nuk ka regjistra të organizatave të shoqërisë civile dhe grupeve të interesit.

6. TË DHËNAT PËR BASHKINË URA VAJGURORE



6.1 Profili i Bashkisë

Ura Vajgurore kufizohet në veri- perëndim me bashkinë Lushnjë, në veri-lindje me bashkinë Kuçovë, në jug-lindje me bashkinë Berat dhe në jug-perëndim me bashkinë e Roskovecit. Kryeqendra e bashkisë është qyteti i Urës Vajgurore.

Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2011, kjo bashki numëron 27,295 banorë, ndërsa sipas Regjistrimit Civil ajo numëron një popullsi prej 39,551 banorë. Me një sipërfaqe prej 156.56 km², ajo ka densitet prej 174 banorë/km² sipas censurit dhe densitet prej 226 banorë/km² sipas regjistrimit civil.

Kjo bashki përbëhet nga 4 njësi administrative, të cilat janë: Ura-Vajgurore, Poshnje, Kutalli dhe Cukalat. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e rrethit Berat dhe pjesë e po këtij qarku. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 34 fshatra.

Bashkia e re shtrihet në një zonë të pasur me toka bujqësore shumë pjellore si dhe me burime të rëndësishme guri. Burimet kryesore të të ardhurave për banorët e kësaj zone bazohen te shfrytëzimi i resurseve natyrore, sidomos atyre të përpunimit të inerteve të gurit dhe të lumenjve, i fermave private, përpunimit agro-industrial, plantacioneve me ullinj, dru frutorë dhe vreshta, perimeve, blegtorisë, si dhe përpunimit të produkteve të qumështit dhe mishit.

Kjo zonë është e njohur herët për minierat sipërfaqësore të gurit, ndërsa kohët e fundit edhe për përpunimin e gurit në granil dhe gëlqere, duke u njohur edhe si “gurorja” e Shqipërisë për shkak të numrit të madh të shoqërive private që kryejnë aktivitetet në këtë fushë.

Me ndarjen e re administrative kjo njësi vendore do të marrë një profil të rëndësishëm bujqësor, të orientuar sidomos në frutikulturë me prodhimin e ullirit, por nuk mbetet pas dhe blegtoria, drithërat dhe perimet, si dhe shumë foragjere. Veçanërisht Komuna Kutalli është e njohur në rang kombëtar për kultivimin dhe hershmërinë e perimeve në serat pa ngrohje. Këtë mundësi ia jep terreni dhe pozicioni shumë i favorshëm gjeografik që i favorizon fermerët të kultivojnë perime, fruta dhe vreshta. Në fshatrat e komunës, mbi çdo copë toke, janë ndërtuar sera dhe çdo vit nga serat e Kutallisë prodhohen mbi 25 mijë ton perime, ku 80 për qind e tyre eksportohen.

Duhet theksuar se reforma e re territoriale e ka vendosur këtë qytet si një zonë pilot të projektit STAR, teksa pritet që bashkimi me komunat e reja të krijojë një njësi funksionale shumë më efektive sesa më parë. Ndonëse projekti pritet të krijojë kushtet për administrim të efektshëm të bashkisë së re, sfidat janë të mëdha për të. Në qytetin e Urës Vajgurore, përgjatë 20 viteve të fundit është krijuar një lagje e re pa planifikim urban, e vila vuan mungesën e infrastrukturës dhe që përmytet herë pas here nga lumi Osum. Kjo nënkupton nevojën që bashkisë së re të ndërmarrë punime të rëndësishme për të parandaluar përmytjet, si dhe të hartojë një plan urbanistik zhvillimor për të shmangur ndërtimet e mëtejshme të pakontrolluara.

Zona e Urës Vajgurore është e njohur për produkte bujqësore të rëndësishme si ullinjtë e Beratit apo vreshtat e shumta për prodhimin e verës. Bashkia e re do të ketë mundësi të nxisë më tej zhvillimin e bujqësisë në këtë zonë përmes sistemeve të certifikimit të cilësisë

apo të promovimit të bujqësisë dhe agroturizmit.

Ndërkohë, rezervat shumë të mëdha të gurit të cilat shfrytëzohen nga qindra familje, një pjesë e të cilave janë jashtë sistemit ligjor ka krijuar shqetësime të mëdha për ndotjen si dhe për dëmtimin e pyjeve që gjenden mbi gurorë. Shumë banorë ankohen për sëmundje në rrugët e frymëmarrjes, të cilat mund të përkeqësohen nga niveli shumë i lartë i pluhurit të krijuar nga shfrytëzimi i gurit. Kontrolli i nivelit të ndotjes si dhe lufta kundër gurorëve ilegale shoqëruar me disiplinimin e arkëtimeve nga renta minerare nga ana e qeverisjes qendrore mund të krijojnë burime të sigurta të ardhurash për bashkinë e re. Ndalimi i përdorimit të furrave artizanale të gëlqeres mund të ndihmojë në ruajtjen e mjedisit dhe shëndetin e banorëve.

Gjithashtu, bashkisë së re do i duhet të përballet me problemet e përmytjeve duke qenë se edhe këtë dimër në zonën e Urës Vajgurore situata ka qenë shumë problematike dhe janë përmytur rreth 100 familje, çka ka kërkuar ndërhyrjen e forcave të ushtrisë. Edhe sipërfaqet e tokës së përmytur janë shumë të mëdha duke dëmtuar rëndë prodhimet bujqësore dhe blegtorale.

Në zonat rurale ka nevojë për përmirësimin e godinave të shërbimit shëndetësor dhe arsimor, rrjetit të furnizimit me ujë të pijshëm, por dhe rritjen e transparencës në lidhje me qeverisjen në kuadër të përmirësimit të shërbimeve që i ofrohen qytetarëve.

6.2 Të dhënat e pyetësorëve për bashkinë Ura Vajgurore

Pyetësorit iu përgjigjen rreth 53% femra dhe 47% meshkuj ndërsa për sa i përket moshës, rreth 38% e të intervistuarve i përkiste grupmoshës 30-50 vjeç, ndërsa rreth 18% u përkisnin repektivisht grupmoshave 18-30 vjeç dhe 37% mbi 50 vjeç. Profesionet e të intervistuarve ishin nga më të larmishmet, duke pasqyruar kështu edhe nivelin arsimor të tyre. Rreth 60% e të intervistuarve kishin arsim të mesëm, 21% të lartë dhe rreth 19% e tyre arsim të ulët (shih tabelat 1, 2, 3).

Gjinia?

Answered: 98 Skipped: 2




Figura 1. Gjinia (Ura Vajgurore)

“Pjesëmarrja e Publikut në Procesin e Vendimmarrjes Vendore”

Mosha?

Answered: 99 Skipped: 1




Figura 2. Mosha (Ura Vajgurore)

Arsimi?

Answered: 99 Skipped: 1




Figura 3. Arsimi (Ura Vajgurore)

Seksioni i parë i pyetësorëve ka të bëjë me informimin. Pyetjes nëse qytetarët kanë paraqitur ndonjëherë kërkesë për informacion u është përgjigjur pozitivisht 67% e popullsisë, ndërsa rreth 33% nuk kanë kërkuar ndonjëherë informacion (shih Tabelën 4).

Keni paraqitur ndonjëherë kërkesë për informacion në bashki?

Answered: 100 Skipped: 0




Figura 4. Kërkesë për informacion (Ura Vajgurore)

“Pjesëmarrja e Publikut në Procesin e Vendimmarrjes Vendore”

Pyetja lidhur me përgjigjen e shpejtë nga bashkia apo nëse kanë marrë informacionin e kërkuar u është drejtuar vetëm të intervistuarve që i janë përgjigjigjur pozitivisht pyetjes së mësipërme, lidhur me kërkesën për informacion.

Rreth 60% e të anketuarve që kanë kërkuar informacion, nuk kanë marrë përgjigje në një kohë të shpejtë dhe vetëm 50% e tyre ka marrë informacionin e kërkuar (figurat 5, 6).

Ju kanë kthyer përgjigje në një kohë të shpejtë?

Answered: 100 Skipped: 0




Figura 6: Përgjigje e shpejtë nga bashkia(Ura Vajguore)

A e keni marrë informacionin e kërkuar?

Answered: 100 Skipped: 0




Figura 6. Marrja e informacionit të kërkuar (Ura Vajguore)

Rreth 55% e të anketuarve nuk janë në dijeni se ka një program transparence në bashki dhe një koordinator për transparencën e institucionit, ndërsa rreth 42% nuk e dinë se në bashki ka një koordinator për njoftimin dhe konsultimin publik (figurat 7, 8).

Pra, gati gjysma e të anketuarve nuk kanë informacion mbi strukturat dhe instrumentet që kanë të bëjnë me informimin dhe transparencën.

Kjo situatë është mjaft e ngjashme me atë të tre bashkive të tjera në shqyrtim.

“Pjesëmarrja e Publikut në Procesin e Vendimmarrjes Vendore”

A e dini se në bashki ka një koordinator për transparencën e institucionit dhe një program transparence?

Answered: 100 Skipped: 0




Figura 7. Informimi mbi koordinatorin dhe programin e transparencës (Ura Vajgurore)

A e dini se në bashki ka një koordinator për njoftimin dhe konsultimin publik?

Answered: 100 Skipped: 0




Figura 8. Informimi mbi koordinatorin për njoftimin dhe konsultimin publik (Ura Vajgurore)

Ndërkohë, rreth 74% e të anketuarve janë në dijeni se bashkia ka një faqe interneti dhe rreth 5% e tyre marrin informacion nga kjo faqe.

A e dini nëse bashkia juaj ka faqe interneti?

Answered: 100 Skipped: 0




Figura 9. Informimi mbi faqen e internetit (Ura Vajgurore)

“Pjesëmarrja e Publikut në Procesin e Vendimmarrjes Vendore”

A merrni ndonjëherë informacion nga kjo faqe?

Answered: 100 Skipped: 0




Figura 10. Informacioni I marrë nga faqja e internetit (Ura Vajgurore)

Përsa i takon punës së sportelit të informacionit, rreth 50% e të pyeturve janë të kënaqur dhe mendojnë se jep informacionin e kërkuar, ndërkohë që rreth 20% mendojnë se nuk i përgjigjet kërkesave dhe rreth 15 % se nuk jep informacionin e kërkuar (figura 11).

Çfarë mendoni për punën e sportelit të informacionit?

Answered: 100 Skipped: 0




Figura11. Vlerësimi mbi punën e sportelit të informacionit (Ura Vajgurore)

Lidhur me faqen e internetit, rreth 18% mendon se nuk i përgjigjet kërkesave, rreth 15% mendojnë se nuk jep informacion e duhur dhe 56% janë të kënaqur nga kjo faqe dhe mendojnë se jep informacionin e kërkuar figura 12).

Çfarë mendoni për faqen e internetit të bashkisë?

Answered: 100 Skipped: 0




Figura 12. Vlerësimi për faqen e internetit (Ura Vajgurore)

Duke bërë një përmbledhje të shkurtër të seksionit të informimit mund të themi se një pjesë e mirë e të anketuarve nuk janë në dijeni të instrumenteve që bashkia ofron për qytetarët apo edhe të prezencës së figurave profesionale. Edhe në rastin kur kanë njohuri për këto shërbime, vlerësimi që japin për to nuk është nga më të lartët.

Seksioni i dytë i pyetësorit përmban pyetje mbi Këshillin Bashkiak.

Rreth 32% e qytetarëve nuk janë të informuar se cili anëtar i Këshillit përfaqëson lagjen/fshatin e tij (figura 13) dhe në rastin e atyre që e dinë, më shumë se 68% e tyre komunikojnë me të lidhur me problemet që u interesojnë (figura 14).

A e dini se cili anëtar i Këshillit përfaqëson lagjen/fshatin tuaj?

Answered: 100 Skipped: 0




Figura 13. Informacion mbi anëtarin e Këshillit që i përfaqëson (Ura Vajgurore)

Nëse po, a komunikoni me anëtarin e Këshillit për problemet tuaja?

Answered: 81 Skipped: 19




Figura 14. Komunikimi me anëtarin e Këshillit që i përfaqëson (Ura Vajgurore)

Rreth 40% mendojnë se puna e anëtareve të Këshillit Bashkiak u shërben komunitetit, rreth 32% mendojnë se nuk i shërbejnë komunitetit dhe rreth 25% mendojnë se u shërbejnë interesave të tyre dhe të familjarëve të tyre (figura 15).

Në rastin e kësaj bashkie, ndryshe nga bashkitë e tjera në studim, vëmë re një informim më të gjërë të banorëve mbi përfaqësuesit e tyre në Këshillin Bashkiak, edhe pse si shihet nga përgjigjet edhe në këtë bashki ndeshet mosbesim te këto figura.

“Pjesëmarrja e Publikut në Procesin e Vendimmarrjes Vendore”

Çfarë mendoni për punën që bëjnë anëtarët e Këshillit Bashkiak?

Answered: 100 Skipped: 0




Figura 15. Vlerësimi mbi punën e anëtarëve të Këshillit bashkiak (Ura Vajgurore)

Seksioni i tretë i pyetësorit ka të bëjë me mbledhjet e Këshillit Bashkiak.

Rreth 75% e të intervistuarve e dinë se këto mbledhje janë të hapura (figura 16), por rreth 65% e tyre nuk marrin pjesë në këto mbledhje. Arsyeja e pjesëmarrjes për 60% është marrja e informacionit, ndërsa 32% kërkon nëpërmjet pjesëmarrjes të ndikojë në vendimmarrje (figura 18).

A e dini që mbledhjet e Këshillit Bashkiak janë të hapura?

Answered: 100 Skipped: 0




Figura 16. Informimi mbi mbledhjet e Këshillit Bashkiak (Ura Vajgurore)

A keni marrë pjesë ndonjëherë në takimet e hapura të Këshillit Bashkiak?

Answered: 99 Skipped: 1




Figura 17. Pjesëmarrja në mbledhjet e Këshillit Bashkiak (Ura Vajgurore)

“Pjesëmarrja e Publikut në Procesin e Vendimmarrjes Vendore”

Statistikat dëshmojnë paqartësinë e qytetarëve lidhur me funksionimin dhe detyrat e organeve të bashkisë, duke humbur kështu rastin e shfrytëzimit të tyre në dobi të interesave të komunitetit.

Përse mendoni se njerëzit mund të jenë të interesuar të marrin pjesë në takimet e hapura?

Answered: 99 Skipped: 1




Figura 18. Arsyet e pjesëmarrjes në takimet e hapura (Ura Vajgurore)

Seksioni i katërt i pyetësorit lidhet me seancat e këshillimeve me bashkësinë.

Gati 80% e të anketuarve janë në dijeni të faktit që Këshilli duhet të zhvillojë konsultime në komunitet para se të marrë vendime (figura 19), por vetëm 30% e tyre kanë marrë pjesë në një seancë këshillimi (figura 20). Rreth 76% e të pyeturve e arsyetojnë mospjesëmarrjen e tyre me mungesën e besimit, ndërsa pjesa tjetër kanë motive të tjera (figura 21).

A e dini se para se këshilli të marrë vendime duhet që të zhvillohen konsultime me komunitetin?

Answered: 100 Skipped: 0




Figura 19. Informimi mbi konsultimet me komunitetin (Ura Vajgurore)

A keni marrë pjesë në ndonjë seancë këshillimi?

Answered: 100 Skipped: 0




Figura 20. Pjesëmarrja në seancë këshillimi (Ura Vajgurore)

“Pjesëmarrja e Publikut në Procesin e Vendimmarrjes Vendore”

Edhe pse ndryshe nga bashkitë e tjera, të intervistuarit e bashkisë Ura Vajgurore janë të informuar mbi detyrimin e këshillit për të konsultuar komunitetin, por vetëm një e treta e tyre ka marrë pjesë në këto konsultime.

Niveli i ulët i besimit është një ndër arsyet kryesore që çon në apati.

Nëse jo, pse?

Answered: 65 Skipped: 35




Figura 21. Arsyet e mospjesëmarrjes në seancat këshilluese (Ura Vajgurore)

Rreth 13% e të intervistuarve do të ishte e interesuar të merrte pjesë në këto mbledhje kur diskutohet buxheti dhe rreth 23% kur vendoset për ndihmën ekonomike, kur vendoset për taksat dhe tatimet janë të interesuar rreth 32%, ndërsa kur bëhet fjalë për investimet në infrastrukturën e zonës janë të interesuar rreth 30% e të intervistuarve. (figura 22).

Kur mund të ishit ju i interesuar të merrnit pjesë?

Answered: 98 Skipped: 2




Figura 22. Arsyet e pjesëmarrjes në mbledhjet e Këshillit (Ura Vajgurore)

Rreth 32 % e të anketuarve janë në dijeni të faktit se komuniteti merr iniciativa dhe ia paraqet ato Këshillit Bashkiak dhe rreth 97% e tyre kanë qënë pjesë e këtyre iniciativave (figura 23).

“Pjesëmarrja e Publikut në Procesin e Vendimmarrjes Vendore”

A e dini që komuniteti merr iniciativa dhe ia paraqet për vendim Këshillit Bashkiak? Nëse po

Answered: 32 Skipped: 68




Figura 23. Informimi mbi iniciativat e komunitetit (Ura Vajgurore)

Nëse mungesës së informimit i bashkangjitet edhe mungesa e theksuar e besimit mund të pohojmë se seancat e këshillimit me bashkësinë nuk kanë funksionuar, apo nuk janë përdorur si instrument i garantimit të një vendimmarrje demokratike e pjesëmarrëse në bashkinë Ura Vajgurore.

Seksionin i pestë i pyetësorit lidhet me pjesëmarrjen në organizimet komunitare: Këshilli Komunitar.

Rreth 65% e të anketuarve janë në dijeni se në zonën e tyre ka një këshill të tillë (figura 24), dhe më shumë se 90% do të dëshironin që ky këshill të përfaqësonte interesin e gjithë qytetarëve (figura 25).

A ka në lagjen/zonën tuaj këshill komunitar?

Answered: 99 Skipped: 1




Figura 24. Informimi mbi Këshillin komunitar (Ura Vajgurore)

Çfarë do të dëshironit të përfaqësonte ky këshill komunitar?

Answered: 100 Skipped: 0




Figura 25. Çfarë do donin të përfaqësonte Këshilli Komunitar (Ura Vajgurore)

“Pjesëmarrja e Publikut në Procesin e Vendimmarrjes Vendore”

Rreth 33% e të intervistuarve mendojnë se pjesëmarrja e tyre në këshill do të ndikonte në zgjidhjet e problemeve të komunitetit, ndërsa 37% mendojnë se shërben për të përcjellë problematikën dhe 29% për të dhënë e marrë informacion.

Pse mendoni se njerëzit duhet të marrin pjesë në këshill komunitar?

Answered: 98 Skipped: 2




Figura 26. Arsyet e pjesëmarrjes në Këshillin Komunitar (Ura Vajgurore)

Të intervistuarit janë shumë të interesuar të diskutojnë mbi problemet që i shqetësojnë dhe gati 90% e tyre shprehen të gatshëm të marrin pjesë në takimet e organizuara. Ashtu si dhe në bashkitë e tjera, besimi që këta banorë kanë në një organ shumë pranë tyre, është shumë më i madh se ai që tregojnë në organet e tjera të bashkive (figura 27).

Do të merrnit pjesë në takimet e organizuara nga këshilli komunitar për çështje që shqetësojnë banorët e lagjes tuaj?

Answered: 100 Skipped: 0




Figura 27. Gadishmëria për pjesëmarrje në takimet e Këshillit Komunitar (Ura Vajgurore)

Përsa i takon seksionit të gjashtë, diskutimeve në publik, rreth 43% e atyre që do të mblidheshin për të diskutuar do të ishte e gatshme të diskutonte problemet para të tjerëve, 12% nuk ka besim dhe rreth 6% ka vështirësi të flasë në publik. Rreth 92% e të anketuarve shpreh gadishmërinë për të kritikuar punën e bashkisë në publik nëse do i jepej rasti (figurat 28, 29).

“Pjesëmarrja e Publikut në Procesin e Vendimmarrjes Vendore”

Nëse pushteti vendor do të bënte një lajmërim dhe do t’u kërkonte banorëve të mblidheshin për të diskutuar problemet e tyre në publik, a do ta kishit problem t’i diskutonit problemet tuaja para të tjerëve?




Figura 28. Diskutimet në publik (Ura Vajgurore)

Nëse do t’u jepje mundësia, a do ta kritikonit punën e bashkisë në publik?

Answered: 100 Skipped: 0




Figura 29. Kritikkat ndaj Bashkisë (Ura Vajgurore)

6.3 Monitorimi i aktiviteteve të Bashkisë

Për të krijuar një panoramë të qartë të situatës në Bashkinë Ura Vajgurore, gjatë periudhës Maj – Shtator 2017, nga Fondacioni “The Youth of Ura” u krye monitorimi i aktiviteteve dhe u mblodh informacioni i nevojshëm lidhur me funksionimin e kësaj bashkie. Instrumenti i monitorimit ishte pyetësori, i strukturuar në katër tema kryesore: informacioni përgjithshëm, transparencën e aktiviteteve, pjesëmarrjen e publikut dhe bazën ligjore dhe dokumentare.

Nga informacioni i mbledhur rezulton se bashkia zotëron një faqe interneti. Ambiente dhe figura profesionale që kanë si qëllim njoftimin e publikut dhe konsultimin e këtij të fundit nuk mungojnë. Po kështu ekziston një program transparence i miratuar.

Përsa i takon transparencës së aktiviteteve të bashkisë vihet re se përgjatë gjithë periudhës në shqyrtim ka një informacion të përditësuar lidhur me aktivitetet e bashkisë, po ashtu edhe mbi mbledhjet e këshillit bashkiak. Ndërkohë nuk ka asnjë informacion lidhur me zhvillimin e seancave të këshillimeve apo dëgjësave. Informacioni mbi strukturat, adresat dhe kontaktet e bashkise nuk mungon.

Sportelet e informacionit dispojnë hapësirë të mjaftueshme dhe personeli nuk mungon.

Shenjat/tabelat që tregojnë ekzistencën e këtyre zyrave nuk janë të pranishme.

Lidhur me pjesëmarrjen e publikut në seancën e këshillimeve me bashkësinë vihet re si prania e njoftimeve ashtu edhe e ambienteve për të lejuar pjesëmarrjen e publikut.

Përsa i përket bazës ligjore dhe dokumentare, rezultojnë iniciativa qytetare për marrjen e vendimeve nga Këshilli Bashkiak apo kryetari i bashkisë të regjistruara dhe është miratuar nga bashkia një rregullore e pjesëmarrjes së publikut në vendim-marrje. Ekzistojnë regjistra të organizatave të shoqërisë civile dhe grupeve të interesit.

KONKLUZIONE

Dukshmëria e veprimit administrativ, e garantuar nga transparenca, nuk synon të sigurojë një vëzhgim të thjeshtë të aktiviteteve të administratave publike dhe të dhënave të saj, por bëhet një instrument i vërtetë i demokracisë pjesëmarrëse, në bazë të së cilës qytetari fiton vetëdije dhe merr pjesë në elaborimin e politikave publike.

Parimi i transparencës gjen një aleat të fortë në web, i cili vë informacionin në dispozicion të një numri të pacaktuar subjektsh, të cilët në çdo kohë mund të përfitojnë nga ky shërbim nga vende të ndryshme fizike.

Duke u mbështetur në rëndësinë e këtij parimi në raportin e paraqitur u monitorua situata aktuale në Bashkitë objekt të studimit dhe u analizuan gjetjet e sondazheve të kryera.

Rezultatet e pyetësorëve tregojnë se në total rreth 70% e të intervistuarve që kanë kërkuar informacion në Bashkinë Devoll, ose nuk e kanë marrë atë në kohë të shpejtë ose nuk e kanë marrë fare.

Pjesa më e madhe e të intervistuarve në Bashkinë Devoll (rreth 75%), nuk janë në dijeni të ekzistencës së strukturave dhe instrumenteve, si programit dhe koordinorit për transparencën apo koordinorit për njoftim dhe konsultim publik që sigurojnë transparencën, por edhe përfshirjen publike në vendimmarrje.

Nga një analizë e kryqëzuar e të dhënave vihet re se vetëm rreth 32% e të intervistuarve arrin të marrë informacion nga faqja e internetit të Bashkisë Devoll.

Rreth 35% e të anketuarve shprehen të pakënaqur pasi mendojnë se nuk jep ofron shërbimin e kërkuar (6%), nuk jep informacionin e kërkuar në kohën e duhur (8%) apo për arsye të tjera nuk është e kënaqur nga puna e sportelit të informacionit të Bashkisë Devoll (20%) (shih figurën 11, Kap. 3).

Rezultatet dëshmojnë mungesën e besimit të qytetarëve në anëtarin përfaqësues në Këshillin Bashkiak dhe shpjegon edhe skepticizmin në përdorimin e këtij kanali për të influencuar në vendimmarrje.

Nësë mungesës së informimit (45%) i bashkangjitet edhe mungesa e besimit (23%), mund të pohojmë se seancat e këshillimit me bashkësinë nuk kanë funksionuar, apo nuk janë përdorur si instrument i garantimit të një vendimmarrje demokratike e pjesëmarrëse në bashkinë Devoll (figurat 19, 20, 21, Kap. 3).

Vihet re se kur bëhet fjalë për çështje të cilat qytetarët i vlerësojnë si me interes dhe impakt të drejtpërdrejtë në jetën e përditshme, gatishmëria e tyre për pjesëmarrje është e

lartë. 95 % e të anketuarve janë të gatshëm t’i dedikojnë kohë dhe energji kontributit për komunitetin e Devollit.

Vetëm 35% e të intervistuarve do të merrnin pjesë në një Këshill Komunitar për të marrë dhe dhënë informacion. Pjesa më e madhe e të intervistuarve do të dëshironte të përcillte problematikat e zonës (33%) dhe rreth 32% do të donte të ndikonte në zgjidhjen e këtyre problematikave (figura 26, Kap.3).

Një pjesë e madhe e të intervistuarve (73%) do ta kritikonte punën e kësaj Bashkie në publik (figura 29, Kap. 3).

Përsa i përket gjetjeve për bashkinë Prrenjas vihet re se: Gati gjysma e të anketuarve iu drejtohet për informacion bashkisë (42%).

Siç mund të vihet re nga përgjigjet, të intervistuarit në pjesën më të madhe jo vetëm që nuk marrin shërbimet e informimit, por edhe kur e marrin kjo nuk ndodh në kohë të arsyeshme. Këto statistika dëshmojnë dobësitë në funksionimin aktual të strukturave të bashkisë Prrenjas (figurat 5, 6, Kap. 4).

Më shumë se 80% e të anketuarve nuk është në dijeni se Bashkia e Prrenjasit ka një faqe internet (figura 9, Kap. 4), dhe rreth 18% e atyre që kanë njohuri marrin informacione nga kjo faqe (figura 10, Kap. 4).

Viht re se ndryshe nga rasti i Bashkisë Devoll, ku njësoj ndesheshim me mungesë informacioni mbi anëtarin që i përfaqësonte, por njëherë që e kishin këtë informacion ishin të gatshëm të flisnin me të mbi problemet që i shqetësonin, në rastin e bashkisë Prrenjas mbi 70% e të anketuarve nuk komunikojnë me këtë figurë.

Nivele shumë të ulëta pjesëmarrje në mbledhjet e Këshillit Bashkiak dëshmojnë një frymë mosbesimi në funksionimin e strukturave vendim-marrëse.

Qytetarët e intervistuar, si në Prrenjas ashtu edhe në Devoll janë të gatshëm të marrin pjesë në organizimet komunitare, dhe besimi i tyre në këtë instrument është shumë më i lartë se në organet e tjera, (6-7% e arsyetojnë mospjesëmarrjen me mungesë besimi).

Pyetjes nëse qytetarët kanë paraqitur ndonjëherë kërkesë për informacion në bashkinë Libohovë u është përgjigjur pozitivisht 70% e popullsisë. Krahasuar me bashkitë Devoll dhe Prrenjas duket se niveli i pakënaqësisë është më i ulët, por gjithsesi rreth 40% e atyre që kanë kërkuar shërbimin janë të pakënaqur.

Rreth 78% e të anketuarve janë në dijeni të ekzistencës së një koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik.

68% e të intervistuarve në Libohovë shprehen të kënaqur nga puna e sportelit dhe shprehen se marrin informacionin e kërkuar, ndërsa 11% e tyre shprehen se nuk e marrin këtë informacion, apo janë të pakënaqur me shërbimin.

Mungesa e faqes së internetit, që konsiderohet si një kanal i thjeshtë në përdorim, i aksesueshëm nga vendndodhje të ndryshme fizike, i shpejtë dhe interakti, e bën atë një mjet informimi të papërdorshëm në bashkinë Libohovë. Statistikat tregojnë se në mungesë të informacionit nga burime të tjera, mbledhjet e Këshillit Bashkiak shihen më shumë si mundësi informimi, se sa si mjet për të influencuar mbi politikën vendore dhe për të ndikuar në vendimmarrje në bashkinë Libohovë.

Niveli i besimit të qytetarëve në këtë Bashki është i ulët, ashtu si në Bashkitë Devoll dhe

Prrenjas. Një pjesë jo e vogël mendojnë se interesat personale dhe favorët vijnë para interesave të komunitetit (42%) (figura 15, Kap. 5).

Situata në Libohovë duket shume e ngjashme me atë në dy bashkitë e tjera. Nëse mungesës së informimit (43%) i bashkangjitet edhe mungesa e besimit (10%) mund të pohojmë se seancat e këshillimit me bashkësinë nuk kanë funksionuar, apo nuk janë përdorur si instrument i garantimit të një vendimmarrje demokratike e pjesëmarrëse në bashkinë Libohovë.

Pjesa më e madhe e të anketuarve shprehet e gatshme të marrë pjesë e të diskutonte në takimet e organizuara nga këshilli komunitar për të diskutuar mbi çështjet që shqetësojnë banorët.

Në të tre këto Bashki banorët e intervistuar, gati në të njëjtën masë (rreth 70%) janë të gatshëm të kritikojnë punën e bashkisë në publik.

Në rastin e Bashkisë Ura Vajgurore, ndryshe nga Bashkitë e tjera në studim, vëmë re një informim më të gjërë të banorëve mbi përfaqësuesit e tyre në Këshillin bashkiak, edhe pse siç shihet nga përgjigjet edhe në këtë bashki ndeshet mosbesim tek këto figura.

Në Bashkinë Ura Vajgurore, gati gjysma e të anketuarve nuk kanë informacion mbi strukturat dhe instrumentet që kanë të bëjnë me informimin dhe transparencën.

Kjo situatë është mjaft e ngjashme me atë të tre bashkive të tjera në shqyrtim.

Edhe pse ndryshe nga bashkitë e tjera, të intervistuarit e bashkisë Ura Vajgurore janë të informuar mbi detyrimin e këshillit për të konsultuar komunitetin, vetëm një e treta e tyre ka marrë pjesë në këto konsultime.

Niveli i ulët i besimit është një ndër arsyt kryesore që çon në apati.

Mbi 90% e banorëve të intervistuar në bashkinë Ura Vajgurore janë shumë të gatshëm të kritikojnë punën e kësaj bashkie.

Një lexim i kryqëzuar i të dhënave të grumbulluara nxjerr në pah dobësitë e bashkive e shfaqura gjatë këtij monitorimi dhe mangësitë në transparencën e institucionit. Mungesa e informimit është në të njëjtën kohë shkak për pasivitet dhe pakënaqësi të qytetarëve me punën e bashkisë, mungesën e besimit etj dhe nga ana tjetër pasojë e mungesës së transparencës së institucionit në vetvete (strukturat, shërbimet, kontaktet).

Qytetarët janë të gatshëm të marrin pjesë aktive në diskutimin e çështjeve që shqetësojnë komunitetin, por në mënyrë paradoksale janë të pakta iniciativat qytetare të regjistruara. Në pjesën më të madhe qytetarët nuk janë të informuar mbi instrumentet legjitime që u mundësojnë pjesëmarrje aktive në qeverisje, dhe nga ana tjetër nuk u lehtësohet kjo gjendje si pasojë e një transparence të pjesshme nga ana e bashkive.

Duke dashur ti rikthehemi sfidave me të cilat përballen bashkitë në fjalë, është e lehtë të vihet re se mënyra më e mirë për të zgjidhur problematikën që shqetësojnë komunitetin është rritja e transparencës, e cila mundëson një pjesëmarrje të qytetarëve në vendimmarrje dhe qeverisje sa më pranë qytetarëve.

SHTOJCA 1

<u>Informimi</u>			
		Po	Jo
	Keni paraqitur ndonjëherë kërkesë për informacion në bashki?	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
	Ju kanë kthyer përgjigje në një kohë të shpejtë?	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
	A e keni marrë informacionin e kërkuar?	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
	A e dini se në bashki ka një koordinator për transparencën e institucionit dhe një program transparence?	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
	A e dini se në bashki ka një koordinator për njoftimin dhe konsultimin publik?	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
	A e dini nëse bashkia juaj ka faqe interneti?	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
	A merrni ndonjëherë informacion nga kjo faqe?	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Zgjidhni			
	Çfarë mendoni për punën e sportelit të informacionit?		
	α. Nuk i përgjigjet kërkesave të qytetarëve	<input type="radio"/>	
	β. Nuk jep informacionin e kërkuar	<input type="radio"/>	
	γ. Jep informacionin e duhur në kohën e duhur	<input type="radio"/>	
	δ. Tjetër (Specifiko)	<input type="radio"/>	
	Çfarë mendoni për faqen e internetit të bashkisë?		
	α. Nuk i përgjigjet kërkesave të qytetarëve	<input type="radio"/>	
	b. Nuk jep informacionin e kërkuar	<input type="radio"/>	
	γ. Jep informacionin e duhur në kohën e duhur	<input type="radio"/>	
	δ. Tjetër (Specifiko)	<input type="radio"/>	

<u>Këshilli Bashkiak</u>			
		Po	Jo
	A e dini se cili anëtar i Këshillit përfaqëson lagjen/fshatin tuaj?	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
	Nëse po, a komunikoni me anëtarin e Këshillit për problemet tuaja?	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>

“Pjesëmarrja e Publikut në Procesin e Vendimmarrjes Vendore”

		Zgjidhni
	Çfarë mendoni për punën që bëjnë anëtarët e Këshillit Bashkiak?	
α.	Nuk i shërbejnë komunitetit	○
β.	I shërbejnë interesave të veta dhe të të afërmeve të tyre	○
γ.	I shërbejnë komunitetit	○
δ.	Tjetër (Specifiko)	○

Mbledhjet e Këshillit Bashkiak			
		Po	Jo
1.	A e dini që mbledhjet e Këshillit Bashkiak janë të hapura?	○	○
	A keni marrë pjesë ndonjëherë në takimet e hapura të Këshillit Bashkiak?	○	○
Zgjidhni			
	Përsë mendoni se njerëzit mund të jenë të interesuar të marrin pjesë në takimet e hapura?		
α.	Për të marrë informacion	○	
β.	Për të ndikuar në marrjen e vendimeve	○	
γ.	Tjetër (Specifiko)		

Seancat e këshillimeve me bashkësinë			
		Po	Jo
	A e dini se para se këshilli të marrë vendime duhet që të zhvillohen konsultime me komunitetin?	○	○
	A keni marrë pjesë në ndonjë seancë këshillimi?	○	○
Zgjidhni			
	Nëse jo, pse?		
α.	Nuk kam besim	○	
β.	Tjetër (Specifiko)	○	
Zgjidhni			
	Kur mund të ishit ju i interesuar të merrnit pjesë?		
α.	Kur hartohet buxheti i bashkisë	○	
β.	Kur vendoset për taksat dhe tatimet	○	

“Pjesëmarrja e Publikut në Procesin e Vendimmarrjes Vendore”

	χ. Kur vendoset për ndihmën ekonomike	<input type="radio"/>	
	δ. Kur vendoset për investimet në infrastrukturë në zonën time	<input type="radio"/>	
	ε. Tjetër (Specifiko)		
Po Jo			
	A e dini që komuniteti merr iniciativa dhe ia paraqet për vendim Këshillit Bashkiak?		
	Nëse po		
	α. Keni qenë pjesë e ndonjë iniciative ?	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
	α. Është marrë në shqyrtim çështja?	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
	β. Gjeti zgjidhje çështja e kërkuar?	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>

Pjesëmarrja në organizimet komunitare: Këshilli komunitar			
		Po	Jo
	A ka në lagjen/zonën tuaj këshill komunitar?	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Zgjidhni			
	Çfarë do të dëshironit të përfaqësonte ky këshill komunitar?		
	α. Interesat e gjithë qytetarëve	<input type="radio"/>	
	β. Interesat vetëm të anëtarëve	<input type="radio"/>	
	χ. Interesat e bashkisë	<input type="radio"/>	
	δ. Tjetër (Specifiko)	<input type="radio"/>	

Zgjidhni		
	Pse mendoni se njerëzit duhet të marrin pjesë në këshill komunitar?	
	α. Të marrin dhe të japin informacion për lagjen / zonën e tyre	<input type="radio"/>
	β. Të përcjellin problematikën e lagjes/zonës së tyre	<input type="radio"/>
	χ. Të ndikojnë në zgjidhjen e problematikave	<input type="radio"/>

“Pjesëmarrja e Publikut në Procesin e Vendimmarrjes Vendore”

	δ. Tjetër (Specifiko)	<input type="radio"/>

		Po	Jo
	Do të merrnit pjesë në takimet e organizuara nga këshilli komunitar për çështje që shqetësojnë banorët e lagjes tuaj?	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
	Nëse Po, do të diskutoni në takim për zgjidhjen e shqetësimeve në lagje?	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
	Nëse Jo, cilat janë arsytet?		
	α. Nuk kam kohë	<input type="radio"/>	
	β. Nuk kam besim	<input type="radio"/>	
	γ. Tjetër arsye (Specifiko)	<input type="radio"/>	

<u>Diskutime në publik</u>			
		Po	Jo
	Nëse pushteti vendor do të bënte një lajmërim dhe do t’iu kërkonte banorëve të mblidheshin për të diskutuar problemet e tyre në publik, a do ta kishit problem t’i diskutonit problemet tuaja para të tjerëve?	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Zgjidhni			
	Nëse jo:		
	α. Nuk kam besim	<input type="radio"/>	
	β. Nuk flas dot në publik	<input type="radio"/>	
	γ. Kam frikë	<input type="radio"/>	
	δ. Tjetër (Specifiko)	<input type="radio"/>	

		Po	Jo
	Nëse do t’u jepej mundësia, a do ta kritikonit punën e bashkisë në publik?	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>

“Pjesëmarrja e Publikut në Procesin e Vendimmarrjes Vendore”

--

Informacion mbi të intervistuarin

		M	F	
	Gjinia	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	
Zgjidhni				
	Mosha:			
	α. Deri ne 18 vjec	<input type="radio"/>		
	β. 18 - 30 vjec	<input type="radio"/>		
	γ. 30 - 50 vjec	<input type="radio"/>		
	δ. Mbi 50 vjec	<input type="radio"/>		
Zgjidhni				
		I Lartë	I Mesëm	8 Vjeçar
	Arsimi	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
	Profesioni			

SHTOJCA 2

Model për monitorim të aktiviteteve të Bashkisë

Emri Mbiemri i Vëzhguesit/Organizata	
Data e vëzhgimit	(dd/mm/vvvv)
Fillimi i vëzhgimit (ora)	
Mbarimi i vëzhgimit (ora)	
1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM	PO JO
A ka bashkia faqe internet?	<input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/>
A ka bashkia zyrë të pritjes me qytetarët/sportel informacioni/one stop shop?	<input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/>
A ekzistojnë, në ambientet e bashkisë stenda apo hapësira ku mund të afishohen njoftime?	<input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/>
A ka bashkia koordinator për transparencën?	<input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> Pozicioni i punonjësit:
A ekziston një program transparence i miratuar?	<input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/>
A ka bashkia koordinator për njoftimin dhe konsultimin publik?	<input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> Pozicioni i punonjësit:
Të tjera?	

2. TRANSPARENCA E AKTIVITETIT TË BASHKISË	
2.1. Faqja e internetit	
A përmban faqja e internetit informacion të përditësuar për aktivitetet e bashkisë?	<p>PO JO</p> <p><input type="radio"/> <input type="radio"/></p>
A përmban faqja njoftim për mbledhjet e këshillit bashkiak?	<p>PO JO</p> <p><input type="radio"/> <input type="radio"/></p>
A përmban faqja njoftim për zhvillimin e seancave të këshillimeve apo dëgjesave me bashkësinë?	<p>PO JO</p> <p><input type="radio"/> <input type="radio"/></p>
A përmban faqja informacion mbi strukturat e bashkisë, adresat dhe kontaktet e tyre?	<p>PO JO</p> <p><input type="radio"/> <input type="radio"/></p>
Të tjera?	

2.2. Sportelet e informacionit

A ka hapësirë mjaftueshëm në ambientet e zyrave/sporteve të informacionit?

PO
JO

A ka tabela apo shenja që tregojnë ekzistencën e këtyre zyrave/sporteve të informacionit?

PO
JO

A ka personel të mjaftueshëm nëpër zyra/sporte informacioni?

PO
JO

Të tjera?

3. PJESMARRJA E PUBLIKUT

A ka në ambientet e bashkisë ose në faqen e internetit njoftime për mbledhje të këshillit bashkiak?

PO
JO

“Pjesëmarrja e Publikut në Procesin e Vendimmarrjes Vendore”

<p>A ka sala e mbledhjeve të këshillit bashkiak hapësirë të mjaftueshme për të lejuar pjesëmarrjen e publikut</p>	<p>PO JO</p>	<p><input type="radio"/> <input type="radio"/></p>
<p>A ka në ambientet e bashkisë ose në faqen e internetit njoftime për seanca të këshillimeve me bashkësinë?</p>	<p>PO JO</p>	<p><input type="radio"/> <input type="radio"/></p>

4. BAZA LIGJORE DHE DOKUMENTARE

<p>A ka bashkia të regjistruara iniciativa qytetare për marrjen e vendimeve nga Këshilli Bashkiak apo Kryetari i Bashkisë?</p>	<p>PO JO</p>	<p><input type="radio"/> <input type="radio"/></p>
<p>A ka bashkia regjistër fizik ose elektronik të organizatave të shoqërisë civile apo grupeve të interesit që veprojnë në territorin e saj?</p>	<p>PO JO</p>	<p><input type="radio"/> <input type="radio"/></p>

“Pjesëmarrja e Publikut në Procesin e Vendimmarrjes Vendore”

A ka miratuar bashkia ndonjë rregullore të pjesëmarrjes së publikut/bashkësisë në vendimmarrje?

PO

JO

5. KOMENTE TË TJERA